



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovac/Kuvendi i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI I KOMUNËS SAKRIFIKUAR / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Nr./Br./No. 46/19 Nr. i faq./Br. str./No. pg. 22

PROCES VERBAL Ata/Datum/Date 27/11/2019

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 30.10.2019, me fillim në ora 10:30. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t’iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkyetar i Komunës z. Fatmir Iska, të nderuar kolegë kuvendarë, drejtore të drejtorive komunale, nxënës të shkollës profesionale “Selajdin Mullaabazi- Mici”, faleminderit për vizitën mësimdhënësve, përfaqësues të KFORIT, media, dhe gjithë ju të pranishëm, hapim mbledhjen e radhës të cilën propozojmë për këtë mbledhje këtë rend të ditës:

### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën kohore janar-shtator 2019,
4. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për fillimin e viti të ri shkollor 2019/2020,
5. Të ndryshme,

**Kryesuesi** - Të nderuar kuvendarë, a jeni për këtë rend dite, po urdhëroni z. Çadraku!

**Dervish Çadraku** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm dhe mysafirët që janë këtu, unë desha paraprakisht para se të caktohet rendi i ditës, në bashkëbisedim me shefat e grupeve parlamentare bazuar në situatën e tashme në Kosovë, intensitetin e shtuar të thirrjes në Gjykatën Speciale të ish ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kemi bërë një deklaratë si shenjë e pakënaqësisë së veprimeve që po ndodhin sot në këtë drejtim, prandaj ne jemi dakorduar qe të dalim me një deklaratë të caktuar në mbrojtje të këtyre vlerave, nëse me lejohet e kisha lexuar menjëherë:

Me rastin e ftesave nga ana e Dhomave të Specializuara të Gjykatës Speciale në Hagë për ish-pjesëtarët e UÇK-së, Kuvendi Komunal i Rahovecit, në mbledhjen e datës 30.10.2019, miraton këtë:

### **DEKLARATË**

Të bindur në pastërtinë e luftës tonë çlirimtare dhe në pafajësinë e pjesëtarëve të UÇK-së, ne anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, konsiderojmë se ftesat e dërguara për ish-ushtarët e UÇK-së janë në adresë të gabuar. Populli shqiptar në Kosovë ka sakrifikuar shumë për lirinë e vet dhe për këtë qëllim ka dhënë shumë gjak e mund dhe ka bërë luftë të pastër për liri e dinjitet njerëzore e kolektivë.

Shkaktar i luftërave dhe fatkeqësive të popujve në Ballkan janë qeveritë e Republikës së Serbisë, gjë që ka provokuar edhe ndërhyrjen ndërkombëtare për të ndaluar gjakderdhjet në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe

në Kosovë. Vrasja dhe zhdukja e mijërave njerëzve, shkatërrimi i pronës, dhunimet e gjymtimet e shumë banorëve të kësaj ane, janë dëshmi të bazuara në fakte të dokumentuara, prandaj mosndëshkimi i krimit dhe i kriminelëve të vërtetë, bie ndesh me parimet e proklamuara botërisht të bashkësisë ndërkombëtare.

Është e drejtë dhe detyrim i popujve që të luftojnë për lirinë e vet, prandaj të akuzohen për krimet luftës atë që luftuan për këtë të drejtë natyrore, konsiderojmë se është jo humane, antidemokratike dhe në kundërshtim me parimet bazë të demokracisë perëndimore.

Për të qenë ironia edhe më therëse „kriminelët, urdhërdhënësit dhe zbatuesit e krimeve kundër njerëzimit vazhdojnë të jenë në liri dhe të pacenuar nëpër Serbi, Republikën Serbe të Bosnjës dhe gjetkë nëpër botë, përkundër shumë fakteve të dokumentuara se kanë kryer krimet çnjerëzorë, grabitje, plaçkitje, djegie e shkatërrime, gjymtime, tortura, dhunime e vrasje të grave e të fëmijëve dhe të njerëzve të pasafajshëm.

Në një situatë të tillë fyeze e poshtëruese për popullin shqiptar, bëjmë thirrje që fokusi i bashkësisë ndërkombëtare të orientohet nga kryesit e vërtetë të krimeve e masakrave në tërë Ballkanin. Ne këtë kuptim, ftesa për Kryetarin e Komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi dhe bashkëluftëtarëve të tij është në vazhdën e gabimeve të rënda historike. Për të qetësuar shpirtin e trazuar të shqiptarëve të persekuar nga makineria serbe, hetimi dhe ndëshkimi i kriminelëve të shumtë serbë, do të ishte gjëja më e drejtë. Besojmë fuqishëm se edhe në këtë rast do të dëshmohet pastërtia e luftës tonë çlirimtare si dhe në hetimin dhe ndëshkimin e krimeve serbe në Kosovë dhe gjetkë në Ballkan. Ju Faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Çadraku, të nderuar kuvendarë a jeni për këtë deklaratë, konstatojmë se unanimisht aprovohet deklarata. Faleminderit shumë!**

Te nderuar kuvendarë, po vazhdojmë me rendin e ditës, kush është për rendin e ditës qe e lexuam paraprakisht, konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Prosesverbalit nga mbledhja e kaluar-** A ka dikush diçka rrëth procesverbalit, nëse jo e qesim në votim, po urdhëroni z.Cena!

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, për nënkyetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët e qeverisë lokale, monitoruesit, nxënësit e shkollës se mesme që kanë ardhur sot këtu me na përcjellë në këtë mbledhje të kuvendit, nëse me lejoni unë kam pak një ndërhyrje të vogël në faqen dy, rreshti 3 lartë është fjalimi im, është diçka e paqartë ku janë vendos shtyllat elektrike nuk janë rikthyer, a ka qenë fjalë për këtë rrugën te Dëshmorët e Pashtrikut, nuk është rikthyer gjendja e rrugës në gjendjen mëparshme e jo shtyllat elektrike ato janë aty edhe më qe mora fjalën janë edhe dy faqe të duplikuara, është faqja 4 dhe 24. Faleminderit!

**Kryesuesi - Faleminderit shumë z. Cena, tjetër dikush, atëherë nëse nuk ka e vëmë në votim, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:**

**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve –**

**Vahid Krasniqi** – Faleminderit kryesues, Kryetar, kolegë asambleistë gjithë ju të pranishëm. Në seancën e kaluar kemi diskutuar me Kryetarin rrëth një çështje të Agjencionit Pyjor të ndërtimit të një shtalle. Për një sqarim të vogël sa i përket Agjencionit Pyjor, këto toka menaxhohen ende prej AKP-së dhe lëshohen me kontrata 1 vjeçare, e diskutuam edhe me drejtorin e meqë drejtori është këtu tash e diskutojmë më gjërësisht dhe lëshohet me kontratë 1 vjeçare dhe jo me kontratë 5 vjeçare por kjo kontratë do të kontrollohet. Unë e kam bërë një kërkësë në AKP dhe ajo më ka sqaruar rrëth kësaj çështje që do të bëhet në një shkresë në menaxhmentin e ndërmarrjes shoqërore dhe ata do të merren me këtë ndërmarrje, kjo sa i përket nivelit qendor ndërsa sa i përket nivelit lokal aty nuk është dasht me u fillua ndërtimi dhe unë kërkoi prej drejtorit inspektues që t'i ndërpresë këto punime deri sa të merr pëllqimin e ndërtimit, ende s'ka pëllqim ose leje ndërtimi, ajo është duke u ndërtuar dhe nuk ka leje as për kyçje në rrugë e ai e ka bë kyqjen, unë kërkoi të ndërprehen për shkak se ka edhe kërkesa tjera nuk është vetëm kjo, i ka mbi 20 kërkesa tjera të çështjeve të ndryshme, deri sa të sqarohet kjo çështje mirë pastaj të fillohet tutje.

**Kryesuesi – Faleminderit z. Krasniqi.**

**Ali Zhuniqi** – Përshëndetje për të gjithë, për nxënësit e shkollës se mesme dhe gjithë të pranishmit këtu, një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë, jemi në kuadër të muajit të aktiviteteve kundër kancerit të gjirit, po sot një

vite kur e kemi mbajte mbledhjen e kam parashtrua një pyetje në lidhje me zhvillimin e këtyre aktivitetave dhe drejtori kaluan gati një vite prapë nuk e shoh që ka mbajte ndonjë aktivitete sa i përket kërkesës së parashtruar nga unë edhe pse publikisht para një viti ka premtuar këtu. Jemi në kuadër të këtij muaji te kancerit të gjirit, e dimë se në kuadër të shoqatës së onkologëve të Kosovës mbahen pra zhvillohen aktivitete në tërë Republikën e Kosovës kryesisht me kërkesa te komunave dhe personave të cilët janë përgjegjës për këtë punë d.m.th. presë qe nga drejtori të jepë përgjegjësi për këtë lloje aktiviteti qe u dashtë me bo kërkese në kuadër të shoqatës së Onkologëve dhe në bashkëpunim me drejtorin e Radiologjisë qe me sjellë Mamografin mobil për shkak se shumë femra te reja, unë jam pjesë e shoqatës së Onkologëve, vinë për shkak të mosvetëdijësimit edhe për shkak të vonesës tyre diagnostikohen me kancer të gjirit andaj si kërkese e tillë kisha kërkua drejtorit meqenëse ka kohë ende të parashtrojë një kërkesë të tillë dhe të bëjë një aktivitet në kuadër të këtij muaji të kancerit të gjirit sikurse ka ndodhur në të kaluarën.

**Kryesuesi – Faleminderit z.Zhuniqi, po urdhëroni znj. Aferdita Thaqi!**

**Aferdita Thaqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, përshëndetje për Kryetarin, kryesuesin. Dëshiroj të informohem si unë po ashtu edhe qytetarët dhe opinionin se çka ndodhi me kërkësen për rinnovimin dhe izolimin e shkollës “Rilindja” në Çifllak, si është e mundur që shkolla “Rilindja” të mos hyj në rend për investime pasi si fshat nuk po kërkojmë ndonjë shkollë të re siç janë investuar në shkolla tjera me vlerë miliona por një investim dhe renovim i kësaj shkolle është shumë e nevojshme. Dihet mirë se në shkollën “Rilindja” më së paku kërkohet investim, kaluan 20 vite dhe shumë pak është investuar për disa renovime të kësaj shkolle andaj si asambleistë vërtetë jam e zhgënjer për mosrregullimin dhe renovimin e shkollës “Rilindja” në Çifllak, mbes me shpresë se kjo kërkesë e imja të merret parasysh dhe urgjentisht të gjenden mjete për renovimin dhe rregullimin e shkollës “Rilindja”. Si temë tjetër është edhe Ambulanca, falënderoj për investimin dhe për objektin që është duke u ndërtuar por kam edhe një mendim kritik pasi që gjërat elementare në Ambulant në “Çifllak” me një numër të tillë popullsisë dhe mos të ketë aparate për matjen e Glikemisë, vërtet është e pakuptimtë dhe e paarsyeshme duhet të kuptojmë se muret dhe objektet vlejnë të ndërtohen por objektet nuk krijojen në shërbimet ndaj pacientëve, pacientet kanë nevojë për pajisje mjekësore më shumë se sa për objekte andaj kërkoj se kjo çështje duhet të rregullohet urgjentisht, te paktën gjërat elementare të janë në shërbim të qytetareve. Tema tjetër vlen të shtjellohet edhe trotuari që janë duke vazhduar punimet, vërejtja e qytetarëve dhe e imja është vërtete është ngushtë që ka vende prej 0.50 cm dhe sipas asaj qe jam e informuar do të ndërpriten deri tek pika e karburantit Elita në Çifllak pasi që nevoja e domosdoshme është të shkon deri tek fusha e sportit, kjo hapësirë krejt 250 metra dhe për këtë largësi të mbetet e pakryer e konsideroj jo të sinqertë dhe jo të arsyeshme të rezikoj të rinjtë e fshatit tim andaj mbes me shpresë ajo pak investim të kryhet dhe të përfundoj ashtu si duhet sepse shumë më me vlerë është jeta e qytetarëve se sa investimi që do të bëhet.

**Kryesuesi - Faleminderit e nderuara, znj. Thaqi, z. Munib Durguti!**

**Munib Durguti** – Përshëndetje i nderuar kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit sidomos për nxënësit e shkollës së mesme “Selajdin Mullaabazi – Mici”, të cilët sot janë këtu për të monitoruar punën e kuvendit, unë e kam një pyetje lidhur me disa komisione që janë formuar prej kuvendit tash e disa muaj dhe fare nuk janë vënë në veprime siç është komisioni për emërtimin e rrugëve të paemërtuara edhe komisioni për formimin e komitetit për shërbime publike, besoj që ky i fundit është formuar në fillim të këtij viti dhe ende nuk kemi asgjë prej saj.

Pjetja ime është që a do të vënë në funksion këto komisione apo vetëm janë formuar formalisht. Faleminderit shumë.

**Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Durguti, po urdhëroni zj. Isma!**

**Vjosa Isma** – Përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime është për drejtorin e Arsimit, desha me pyet për vendin e lirë të punës që është liruar në shkollën “Xhelal Hajda – Toni” për lëndën e Fizikës, për arsyen se Floriana Oruqi ka dalë në pushim të lehonisë por nuk është shpallur vendi i lirë fare për atë lëndë dhe për shkollën Bekim Sylka që është pranuar një mësuese pa konkurs fare, nëse ka përgjigje për këto dy pyetje. Faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit e nderuar, z. Kryeziu, pastaj z. Ali Morina!**

**Refki Kryeziu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për nxënësit e shkollës „Selajdin Mullaabazi- Mici, gjithashtu përshëndetje edhe për dy kolegët e mia, unë kam një pyetje për Kryetarin, pyesin qytetarët e Xërxes se çfarë po ndodhë në rrëth rrötullimin në Xërxe ku dihet se rrezikshmëria aty është shumë e madhe meqenëse kemi dhe qëndron aty pranë shkollës, kur do të përfundon dhe a ka ndonjë periudhë kohore. Faleminderit !

**Kryesuesi** – Faleminderit z Kryeziu, z. Morina!

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuar Kryetar, drejtore të drejtorive komunale, kolegë asambleistë, të dashur nxënës, unë desha me ngritë një shqetësim të vogël të banorëve të fshatit Gexhë, ne vazhdimisht kalojmë përgjatë rrugës dhe një pjesë e trotuarit që përshkon rrugën kryesore të fshatit Gexhë është i shkatërruar dhe me një ndërhyrje të vogël do të pamundësonte shkatërrimin edhe më të madh të këtij trotuari. Aktualisht kompania që e ka pas tenderin, renovimin e rrugëve e trotuareve nuk e di a e ka kontratën valide apo jo mirëpo e njëjtë kompani është duke rregulluar trotuarin në Çifllak, ndoshta me një insistim të vogël të drejtorit do të rregullohej ajo dhe nuk do të vazhdohej shkatërrimi i këtij trotuari. Faleminderit!

**Kryesuesi** - Faleminderit z. Morina, tjetër dikush, atëherë nëse nuk ka dikush tjetër të lajmëruar, urdhëro zj. Rukije Krasniqi!

**Rukije Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për Kryetarin dhe gjithë të pranishmit në këtë kuvend, kisha një pyetje rrëth pengesave nëpër rrugë të asfaltuara sidomos në pengesën e madhe në Nagavc dhe në Fortesë përgjatë rrugës në Celinë dhe në fshatra tjera të komunës sonë gjithashtu edhe në qytete. A ka mundësi nëpër ato shkolla sidomos ne Nagavc më bë një pengesë të standardizuar dhe jo me atë çimento që është pothuajse shumë e rrezikshme për automjetet gjithashtu edhe për pengesa tjera që i përmenda më parë, kjo vlen edhe për qytetin. Ju faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë e nderuar Krasniqi, tjetër dikush, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, po urdhëroni Kryetar!

**Kryetari** – I nderuari kryesues i Kuvendit, anëtarë të kuvendit, drejtore të drejtorive, nxënës të shkollës se mesme profesionale “Selajdin Mullabazi – Mici”, mësimdhënës, përfaqësues të mediave, përfaqësues të LMT-së pra të KFOR-it austriak, OSBE-së dhe gjithë ju të pranishëm. Unë i regjistrova disa pyetje të cilët ndoshta kërkohen përgjigje nga ana ime, besoj qe Vahidi ka marrë një përgjigje prej drejtorit të drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ë vërteta është që ne vetëm vërtetim urbanistik lëshojmë për tokat të cilat janë nën menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës, ndërsa tokat të cilat i administron Agjencionit Kosovar i Privatizimit ka një procedurë tjetër. Pajtohem plotësisht që duhet me pas sepse kontratatë gjitha ata i bëjnë, në vetëm vërtetim për statusin e pronës, dikur më herët janë lëshuar pëlqimet mirëpo tash vetëm vërtetim urbanistik, pajtohem që duhet me u pajis me leje, tash nuk e di sepse është në përgjegjësinë e drejtorit të Urbanizmit të jep shpjegjime edhe pajtohem që duhet me pas edhe çasje në rrugë duhet me pas një leje edhe unë po flas në parim pa i ditur specifikat mirë, ndryshtë afatin e kontratave nuk e përcaktojmë ne, e përcaktojnë ata që e kanë një ligj që administrojnë ose menaxhojnë me ato prona. Pra dikur ka qenë 3 vjet me të drejtë vazhdimi e tash me gjasë është 5 vjet por nuk është në përgjegjësit tonë kur nuk është prona e jona ndërsa kur është prona e një agjpcionit tjetër atëherë i kanë përgjegjësitë edhe rregullat e veta të lojës dhe në bazën e atyre rregullave ata operojnë, pajtohem me Vahidin që ne duhet me rritë kontrollin me mbikëqyrë dhe në qoftë se ka diçka të paligjshme ose në kundërshtim me ato qe janë në përgjegjësi të komunës ne mundemi me i ndërpren punimet unë po i sugjeroj edhe drejtorit të Inspektoratit edhe drejtorit të Urbanizmit në prani tuajën por edhe të drejtorit të Bujqësisë që apo i përgjigjet këtij plani të biznesit mbi bazën e te cilit e ka nënshkruar kontratën me agjencionin atje qe ja ka dhënë të drejtën për 5 vite apo çka, pra po do me lanë temë të hapur por me kujdesin që drejtorët e drejtorive që kanë specifikisht punë rrëth kësaj çështje në kuadër të përgjegjësive si komunë me i ushtruar përgjegjësit e veta dhe me pa ku jemi. Te muaji i kancerit te gjirit, po e shfrytëzoj rastin meqë nuk është drejtori i Shëndetësisë këtu, është me një detyrë tjetër, e di qe ka pas disa aktivitete ama në kuadër të detyrave ose përkushtimeve komunale qoftë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare qoftë të grupit joformal të grave qoftë te SHL-Kosova, shoqatës Hareja bile unë kam qenë i ftuar pothuajse në të gjitha aktivitetet edhe ne aktivitetin përbyllës i cili është mbajtur dje apo pardje e që s'kam mundur me qenë

fizikisht, pra pajtohem me Aliun që duhet me sensibilizua edhe më shumë, duhet me i ftuar kompetentet me ardh me dhanë sqarime e udhëzime shtesë për parandalim, për krejt çka duhet qe më qenë më të mbrojtur prej kësaj sëmundje që i kërcënnon qytetarët tonë qofshin gra apo burra. Për një mamograf mobil ne kemi aplikuar në Ambasadën Japoneze, shpresoj që ta kemi tonin kemi zotim prej Ambasadës Japoneze që kanë njëfarë fondi ata siç e kemi marrë një kamion zjarrfikëseve sivjet e që vitin e ardhshëm shpresojmë që ta kemi mamografin mobil e që unë e kam edhe nënshkrimin aty e që besoj qe ka me i shërbye deri diku ose ka me mujtë me i shërbye atyre që kanë nevojë për kontrollin ose për me përdorë këtë pajisje e që besoj që është moderne, ne vetë nuk kemi mundësi me bë, e presim si donacion nga ata, unë jam i bindur që kemi me fituar sepse kur na kishin thënë për kamionin e zjarrfiksëve ashtu edhe na ka dal edhe për këtë vetë ata që janë aty edhe Rahoveci do ta ketë një mamograf mobil, ne qoftëse ke ndonjë mundësi me i sjell onkologët, radiologët edhe nga SHQUK-ja, ne besoj që jemi të gatshëm edhe i mirëpresim edhe do të kujdesemi për logistikë që ata të kryejnë punën e vetë sepse ka kohë e di qe ka kohë ende për të zhvilluar edhe ndonjë aktivitet që është edhe më profesional edhe më i mirë i arsyeshëm edhe më produktiv se sa që kemi mundur, unë i përgëzoj këto aktivitete që i kanë bërë QKMF-ja, drejtori, punëtoret shëndetësorë, SHL- Kosova, shoqata Hareja, grupi joformal i grave kanë qenë të përfshirë edhe kanë ndërmarrë disa aktivitete edhe nëpër do shkolla kanë qenë etj. por nuk janë të mjaftueshme kuptohet që ka nevojë më shumë. Shkolla ne Çifllak besoj që ka pasur disa renovime me herët Afërditë, por nuk janë të mjaftueshme kulmi, nxemja qendrore, operatori "Isa Dekor" që është një operator që na ka krijuar vështirësi, që është një kontratë e mëhershme edhe akoma edhe sot e kësaj dite kemi vështirësi me ja krijuar situatën qe ai me vepru edhe me i krye këto shkolla që i ka për detyrë e njëra nga ato shkolla ku ka nevojë për intervenime të mëtutjeshme për renovime është edhe shkolla "Rilindja" në Çifllak, pra me sa e di unë është edhe në projektin e eficiencës energjisë, me than të drejtën me shume vështirësi pasi e kemi lajmërua rastin në antikorruption sepse na i kanë hequr projektet e komunës, e kemi nxjerr shkollën e Drenocit, shkollën e Nagavcit edhe shkollën e Pastaselit e në këtë mënyrë do të nxjerrim edhe shkollën e Çifllakit që me i krye sepse janë projekte të Agjencionit për Eficiencë të Energjisë, i kryen me do fonde që i kanë ata të Bashkimit Evropian, shpresoj që do të vije ajo ditë ku me pas renovime, pra nuk është çështja ndoshta edhe qeveria e kaluar e ka lënë për shkak të mungesës së mijeteve po janë projekte të cilat janë pritë me u fitua por janë zgjatë e nuk varen nga komuna, ne po bëjmë presion prej komunës se ata kanë tentua me i zhvendosë projektet tona me i dërgua nëpër do komuna tjera por ne i kemi rikthyer por është një procedurë që zgjatë pak e qe po shpresojmë edhe shkolla e Çifllakut. Sa i përket trotuarit, unë jam i interesuar si Kryetar i komunës edhe në emër të tuajin trotuari ku kemi mundësi prej Kramovikut deri Gradish por mundësit tona buxhetore tash në këtë fazë ku jemi për këtë vite është deri te zona e banuar në Çifllak përndryshe krejt vija Gradish-Kramovikë ka nevojë për trotuare e që ka edhe vija tjera qe kanë nevojë për trotuare sepse kërcënohemi por ajo vijë unë po shpresoj vitin e ardhshëm sepse ne kemi mundësi me investua më shumë në trotuare por jo në këtë vite vetëm në qoftë se kompania na mirëkupton dhe me sa e di unë është në fund të hargjimit të sasive qe i ka të përcaktuara me kontrata, unë besoj qe do të kemi një kontratë ku trotuaret me prioritet do të janë prej Kramovikut ku nuk ka trotuare e deri në Gradish, disa zona të banuara ka trotuare e shyqyr që janë por aty ku nuk ka krejt vijën gjatë rrugës rrafshore duhet me bo me trotuare.

Për sa i takon pajisjeve mjekësore, unë e kam e nënshkruar me sa e di unë është në përbyllje procedura për pajisje mjekësore, vegla te cilat i ka sjell QKMF-ja kërkesat, që ma merr mendja do të kemi mundësi me pas më shumë pajisje mjekësore në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në Ambulantet e Mjekësisë Familjare dhe do të kemi mundësi prapë, presim zbatimin e kontratës në momentin që ndoshta edhe është nëshkruar, nuk jam shumë i sigurte, nuk mundem me fol shumë me kompetencë veç e di se fazë e vlerësimit ka ec dhe a u lidhë kontrata apo jo, a janë krye të gjitha procedurat nuk e di. Objekti i QMF-së është objekte atje qe ka qenë i domosdoshëm me u bo edhe është në fazën e ndërtimit e që shpresojmë të përbyllim sa më shpejtë.

Të pengesat në rrugë në Nagavc, është rrugë rrafshore, pengesat që janë vendosë janë ilegale pra nuk i ka vendosë shteti, institucion, komuna por i ka vendosë e qe nuk e di qysh i kanë vendosë ata në emër të mbrojtjes e qe ka pas disa fatkeqësi aty me lëndime të renda po ashtu edhe me fatalitet por pengesa është pa

standarde, unë pajtohem që ne mundemi me ndërmarrë masa me kërkua prej Ministrisë së Infrastrukturës me sjellë inspektoratin e Ministrisë së Infrastrukturës sepse është rrugë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës. Ai përket rreth rrotullimit në Xerxë Refki është një kontratë, tash s'po du me tregua historinë e kontratës e nënshkruar qysh në kohë kur ka qenë Ministër Lutfi Zharku dhe rreth rrotullimi në Krushë ka disa probleme pronësore, ka disa problem që lidhen me pronësinë qe ka hekurudha dhe bordi i hekurudhave Trainkosi, Infrakosi ishin ja dy borde kanë problem sepse me gjasë është aty dikush pengesë dhe nuk po e ekzekutojnë vendimin. Pra sa unë kam informata qe jam i interesuar shumë, çështja është në përgjegjësi të plotë të Ministrisë se Infrastrukturës dhe në zgjidhjen e konflikteve pronësore që ka Ministria e Infrastrukturës me Infrakosin apo Trainkosin që janë ato bordet qe i kanë në pronësi, edhe tash pse po zgjat është shqetësuese që po zgjatë, është e vërtetë që kompanisë ju kanë ndërprerë punimet nga konflikti pronësorë ose kontesti pronësorë që ka vet shteti jonë, Ministria e Infrastrukturës se nuk janë prona komunale por janë prona nën menaxhime të hekurudhave të Republikës së Kosovës, kur ka me ndodhë, ata neve na kanë thanë që tash po shkojmë drejt zgjidhjes po fakti që s'po ndodhë është shqetësuese,e kemi edhe një zgjidhje tjetër në momentin kur ta nënshkruajmë kontratën tash me rrugën katër korsi, nënkalimin në Xerxe, ka pësuar ndryshime për shkak të projektit të ri që duhet me ju përshtat projektit të ri, në qoftë se tash ne do të kemi një mbështetje një seriozitet më të madhe të mekanizmave kompetentë qe kanë e përmenda edhe me herët problemet se gjysma e objektit duhet me u rrëzuar aty ,një qebaptore qe është pra janë disa probleme qe na nuk kemi të drejtë me ndërmarrë për shkak se nuk është në kompetencat tonë kështu është problemi, ashtu e kemi edhe me Krushë kush do që më pyet ka disa situata të paqarta, kemi marr zotime që duhet mu zgjidhë ai problem, dikujt merret prona krejt i shkon deri te shtëpia disa familjeve e dikujt më pak i merret, për këtë kanë ngecë, kontratat janë valide por punimet kanë ngecur.

Ali Morinës ju përgjigja te renovimi i trotuareve, na kemi mundësi me bo diçka në këtë drejtim, trotuaret atje në Gexhë pak prishen se nuk është marre me thanë se na nuk mundemi me u krenua me kualitet edhe pse kanë ndodhur para 6 vite por pak edhe prishim vet na, i bëjmë disa veprime, inspektorati nuk është aktivë sa duhet sepse edhe kur të ndërmerr dikush veprime duhet me ardhë me marr leje te inspektorati edhe me kthyë në gjendjen e mëparshme e që plotë probleme të kësaj natyre ka edhe plotë vështirësi na krijohen neve për shkak se nuk e kthejnë kurri në gjendjen qysh ka qenë edhe është dëmtuar shumë edhe po dëmtohet vazhdimisht por unë shpressoj se ne duhet me përfunduar trotuarin në vijën Gradish – Gexhë - Malësi e Vogël –Ratkoc – Dejnë – Dobidol – Çifllak - Kramovik e që në disa pjesë ka trotuare por ku nuk ka duhet me përfundua.

Nuk e di a i kam mbetur dikujt borgj edhe Munibi ka pyetur për fatin e komisioneve të cilat ngnjëherë në Jugosllavinë e Titos thoshin përpara kur donin mos me krye ndonjë punë formonin komisione. Komiteti për Shërbime Publike që janë mekanizma këshill-dhënës që i krijon Kuvendi i Komunës dhe Komitetet tjera këshillëdhënëse fatkeqësisht ne kemi obligime statusorë, kemi obligim ligjor për me funksionua por nuk e di nuk ka akoma një ndjenjë, një përkushtim për me i funksionalizuar këto komisone, e di mirë qe ky kuvend vendosë për me i formua ato komisione edhe më duket nuk është ndërmarrë asnjë veprim serioz edhe bile bile se Përparimi nuk është këtu, më ka thënë se nuk ka edhe interesim hiq sepse konkursi ka qenë i hapur edhe nuk ka konkuruar bash hiq askush, tash a është mirë me lan me kaq, unë mendoj përsëri me u hapë konkursi edhe ndoshta kush keni ndonjë ide interesante me i thënë dikujt konkurroni konsiderohet këshillëdhënëse, me gjasë vetëm ka 30 euro i marrin kur të mblidhen ndonjëherë edhe ndoshta nuk ju duket interesant njerëzve edhe me konkuruua, në qoftë se ka interesim dikush ne konkursin e kemi te gatshëm, atë shablon e qesim edhe njëherë në publik dhe le të konkurrojnë, unë jam për funksionalizimin e komiteteve këshillëdhënëse qofshin ato shërbime publik, për shëndetësi, për arsim, për krejt çka mundemi me vendos ne në Kuvend të Komunës. Vjosa Isma ka pyetur, por unë e kisha ftue Avninë me dhënë përgjigje më konkrete për shkak se në tema konkrete mundem mos me qenë konkret.

**Kryesuesi – Faleminderit Kryetar, urdhëro z.Zhuniqi!**

**Ali Zhuniqi** – Kryetar unë e kuptoj arsyeshmerinë e përgjigjes tuaj karshi drejtorit por nuk e arsyetoj veprimin e tij karshi kërkëses që unë kam bërë si shqetësim para një viti drejtorit, unë e di që drejtorët duhet me pas qëllime së paku në periudhën një vjetarë me planifikua edhe mbi ato qëllime me bo prioritete edhe një prioritet

kérkesë që kam kérkua unë te kjo kategori, unë nuk mendoj që ka bo shumë drejtori pér arsy e përmendë nëse kam unë mundësi në lidhje me kontribuua unë diçka në këtë lloje aktiviteti, unë po ju kam thënë në momentin qe qeto janë rrugët ligjore, së nuk mundesh ti me i thanë shoqatës së onkologëve a po vini nesër në Rahovec dhe ata me ardhë menjëherë këtu, ne mandatin e kaluar kur ka qenë Idriz Vehapi ka shkuar nëpërmjet rrugëve ligjorë duke bërë një kérkesë në Shoqafën e Onkologëve në bashkëpunim me ta dhe është zhvilluar aktiviteti, nuk mundem unë vetë me kérkua një aktivitet veq si asamblistë dhe me shprehë si shqetësim sepse unë kam biseduar në lidhje me këtë situatë, është mirë pér arsy se më së paku janë diku 10-15 pacientë të komunës së Rahovecit që trajtohen të përfshirë edhe vajza të reja edhe gra por edhe burra, është mirë që me pas si prioritet sepse është sëmundje në rritje që me marr më seriozisht drejtori këto punë, duhet me pas prioritete ai, jo këtu me ardhë edhe me arsyetua atë, ju duhet të bisedoni me atë dhe ai me i ndjekë këto rrugë se qysh me i prua ata këtu dhe nuk është në përgjegjësinë time.

**Kryesuesi – Faleminderit z. Zhuniqi!**

**Kryetari** – Unë nuk po e arsyetoj as drejtorin as ty, unë po them që ka nevojë pér aktivitete të tilla, nëse keni ju një ide konkrete që unë duhet me ftua dhe ju e dini se unë jam krejt i pazoti, mundem me thirre një onkolog edhe me i thënë apo vini krejt ekipi edhe vinë pa i thirr me shkrim por në qoftëse kjo punë ka nevojë me u bë edhe unë po them që ka nevojë me u bë, ata që janë profesional pasi që ti po punon me këto, ju duhet me ndihmua komunën tuaj, duhet me i ndihmua qytetarët e komunës tuaj edhe me dhënë një ide konkrete ose drejtori i QKMF-së ose qe ku e kemi Fehmi Cenën pa dashtë me i dhënë rast dikujt që pasi që ma përmende emrin, këta që janë pak më profesional edhe janë profesional edhe që merren me këto tema në përditshmëri p.sh. minden me na sugjerua neve si Kryetar që të bëjmë një shkresë ose drejtor, nuk është marre hiq bile është nder edhe e pranoj kur unë nuk mundem me ditë këtë punë, mua ma kanë kérkuar një aktivitet këto gratë joformale, SHL-ja, Hareja edhe me gjithë dëshirë e kemi angazhuar QKMF-në por duhet edhe dy aktivitete tjera, jepni një ide konkrete edhe s'ka nevojë hiq këtu me u lakua emri i drejtorit të shëndetësisë sepse ju duhet me pas parasysh se ne nuk mundemi me i. ditë krejt gjërat edhe sikur të ishim supermen, neve na kérkon dikush një aktivitet edhe unë ju rri karshi po ashtu edhe drejtori, në qoftë se duhet me bo një shkresë se ata na vijnë, unë qysh tani e bëj tash ne mundemi me bë një shkresë, nuk është ndonjë problem pra ne nuk po themi se jemi më të mençurit dhe i dijmë të gjitha përkundrazi kush ka diçka konkrete ne pér atë punë jemi, veç a mundemi me ju ndihmua ne grave ose njerëzve që rrezikohen apo kërcënohen nga kjo lloj sëmundje që siç e thatë është në rritje. Pra unë nuk po du me fol as keq as mirë as pér ty e as pér drejtorin, por unë po them se këtu jemi edhe ne mundemi me shfrytëzua edhe këtë kohë mjaftueshmë pér me bë edhe ndonjë aktivitet edhe më kompetentë edhe më profesional edhe me ju shërbyer njerëzve tanë që së paku në situata të tilla me ndërmarrë masa dhe veprime parandaluese pér këtë sëmundje po e dimë se çka është edhe unë që jam laik pér këtë punë po e di se keq është kanceri dhe nuk po zgjedh as presidentin e SH.B.A-së dhe çka të kemi mundësi këtu jemi edhe përgjigja ime nuk është me arsyetua dikë, përgjigja ime është me të ftua edhe ty edhe kush din edhe kush ka ide konkrete pse jo.

**Kryesuesi – Faleminderit Kryetar, urdhëroni znj. Thaqi!**

**Aferdita Thaqi** – Kryesues me shume keqardhje, nëse Kryetari kérkon diçka konkrete pér temën, unë po them se kam një informacion konkret që do të lidhem edhe duhet të me jepni fjalën, Kryetar mua më pëlqej përgjigje që dhatë, kam kérkuar pér mamaografi edhe kur të vjen, Alia nuk e di sa është në ngjarje, unë jam në ngjarje plotësish me këtë temë pasi që edhe punoj me këtë profesion, Alia duhet me sigurua dikënd pér me ja lexue mamografin sepse ai është një fotografim shumë i thjeshtë që e bën secila motër me një muaj trajnim, nuk është problemi pér me u bo memografia por është problemi ti me ja sigurua Kryetarit kush ja lexon atë sepse menzi na kanë pranuar me lexua në Gjakove një në Prishtinë, Kryetari e ka bë zgjidhjen po ta sjell por ti sigurohu kush me lexua pra ky është problemi.

**Kryetari** – Faleminderit, ne qoftë se nuk mundeni t'a siguroni ju, ketë e siguroj unë mirëpo merreni vesh ju mes veti edhe çka keni konkret unë këtu jam. Faleminderit shumë.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë znj. Thaqi, Kryetari i dha sqarimet që kishte por t'i kryjemë obligimet njëherë pyetjeve me radhë, znj. Isma ka bërë pyetje, Kryetari tha se drejtori është këtu edhe ndoshta mund të ketë një përgjigje pastaj Munib Durguti për çështjen e komisioneve që e sqaroi Kryetari.

**Avni Morina** – Përshëndetje kryesues, Kryetar, të nderuar asamblistë e posaçërisht ju nxënës të shkollës së mesme profesionale, e nderuara zj Vjosa Isma, faleminderit për pyetjen, ju kishit dy pyetje që faktikisht janë të së njëjtës natyrë, supozuat që është vend i lirë në shkollën “Xhelal Hajda-Toni” për Fizikë, ne nuk hapim konkurse pa e bërë planifikimin e orëve në çdo fillim viti shkollor, nuk ka pasur vende të lira sepse orët që janë liruar nuk janë të liruara, janë punëtorët që janë brenda sistemit e që janë në listën e pagave dhe që kanë pasur nevojë për orë dhe ato orë i kemi shpërndarë të asaj punëtores që ka dalë në pushim të lehonisë, pra është Valon Kabashi, Aida Dula janë punëtore tjerë fizikanë që janë aty në atë shkollë dhe ne këtë e kemi të rregulluar edhe me Udhëzim Administrativ nga Ministria e Arsimit se në qoftë se ka raste ka mësimdhënës të lëmisë përkatëse që kanë mangu orë të mos hapet konkurse sepse jemi dëshmitarë të faktit se po zvogëlohet numri i nxënësve çdo vit, vetëm në atë shkollë janë dy klasë mangu këtë vit në gjimnaz, vjet kanë qenë 8 kurse sivjet janë 6 dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve ka shkaktuar zvogëlimin e numrit të klasave dhe rrjedhimisht numrit të orëve, ndërkohe është kthyer edhe Valon Kabashi i cili ka qenë në pushim pa pagesë për një vit sipas ligjit dhe nuk ka orë të tjera për të hapur konkurs ndërsa te çështja e Bekim Sylkës, nuk është e vërtetë mësuese që është punuar pa konkurse, mësuesja që punon aty është e pranuar me konkurse ka qenë në listën e pagave brenda sistemit të pagave dhe ne nuk kemi asgjë tjetër veçse e kemi zbatuar rekomandimet qe i kemi marrë nga Ministria e Arsimit d.m.th. punëtorët që janë brenda sistemit ju kemi dhënë orë.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor!

**Vjosa Isma** – Sa i përket për mësuesen qe po thoni se është në listë të pagave, unë sa e di për atë vend që ajo ka qenë zëvendësim, e në listë të pagave është kthyer mësuesja në qershori mësuesja qe ishte aty duke punuar kështu që tregomë ti mua si mundet dy mësuese me qenë për të njëtin vende të punës në listë të pagave ose e ke shpërblye mësuesen e ke pranuar prapë. Në tetor e keni lënë në listë të pagave me marrë rrogë e nuk i ka takuar e sa i përket “Xhelal Hajdës” atje që është Aida Dula, sa e di unë ajo nuk është përkatëse për me punua në shkollë të mesme, ti mundesh me i sistemuar njerëzit që janë përkatës mësimdhënës që kanë kualifikim përkatës nëpër vende me ju dhënë orë por mësues që janë për fillore e me i bartë në shkollë të mesme me punua pa pasur kualifikim përkatës që duhet. Faleminderit!

**Avni Morina** – Të gjithë ata mësimdhënës që i përmende janë të kualifikuar përkatës, ata janë duke punuar që disa vite aty, nuk janë që janë pranuar as vjet e as sivjet ndërsa te rasti i Bekim Sylkës, sikur të kisha një shkop magjik do të zgjidhja problemet me shkop magjik mirëpo disa probleme nuk zgjidhen me shkop magjik, në vazhdimit e kemi problemi e futjes se listës së pagave të punëtorëve të ri dhe në rastet kur nuk mundemi ti fusim menjëherë muajin e parë apo të dytë ne i fusim ne muajt e tjerë dhe në momentin kur paraqitet nevoja që një fond i orëve të caktuara në një shkollë në një lëndë mësimore apo në një cikël ka nevojë të plotësohet, në i shfrytëzojmë mësimdhënësit qe i kemi brenda listës së pagave e ju mund të vërtetoni edhe vetë që mësimdhënësja në fjalë të cilin po thuhet se është pa konkurs është e pranuar me konkurs në momentin kur ajo është e emëruar aty, e ka emrin në listën e pagave edhe nuk ka kurrfarë shkelje aty d.m.th. nuk ka asgjë të parregullt.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë drejtor për sqarimin, urdhëro z. Durguti!

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, unë kërkova fjalën në temën paraprake dhe dëshiroj të japë disa sqarime, mëqe kam qenë drejtor në shëndetësi në mandatin e kaluar, kolegu Aliu është e vërtete qe ka dy vjet që po e ngrit këtë shqetësim, për informim të opinionit ne kemi zhvilluar mjaft shumë aktivitete në këtë drejtim sepse tash shëndetësia primare e ka edhe promovimin e shëndetit publik, në kuadër të promovimit është obligimi i drejtorit që t'i shënojë disa data kyqe që ndikojnë në përmirësimin e shëndetit publik e në mesin e tyre është edhe luftimi i sëmundjeve të rënda apo në këtë raste kanceri i gjirit. Grupi joformal i grave është e vërtetë që ka bërë një kërkësë te ekipi ekipi i mamografit mobil por edhe drejtoria ka bërë disa kërkesa dhe i ka zhvilluar disa takime me ta, e kemi parasysh e kemi vetëm një ekip mobil që përshkruan gjithë territorin e Kosovës dhe aty ndodhin mjaft shumë intervenime, nuk është e paktë qe drejtori të zhvilloj takime

por në disa raste është e nevojshme edhe mbështetja e Kryetarit edhe besoj që duhet t'i kushtohet një rëndësi e madhe. Kujtoj që ne e kemi pasur atë ekip për një muaj e gjysmë në territorin komunës tonë përveç kësaj kemi zhvilluar edhe një tribunë shkencore me mjekë ekspertë të kësaj fushe me onkologë ku në bashkëpunim me një organizatë lokale SHL-Kosova kemi bërë një tribunë mjaftë të mirë dhe interesimi i grave ka qenë i jashtëzakonshëm në ato dy orë ligjërim edhe në ato fletushka në kuadër të promovimit, e kjo mund të bëhet edhe tani edhe unë nuk e kuptojë pse nuk po vazhdohet më qenësë është trasuar një rrugë e mirë edhe është lehtë me u vazhduar, po ashtu edhe dita e duhanpirjes kemi bërë mjaftë aktivitete nëpër shkolla edhe nxënësit e dinë i kemi këtu, angazhohen mjekët dhe japin ligjérata e shpërndajnë fletushka dhe kjo do të ishte ajo. Ju faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit shumë për kontributin drejtor, urdhëro Ali Zhuniqi!**

**Ali Zhuniqi –** Pas këtij sqarimi qe bëri zotëri Durguti nuk besoj qe ka nevojë besoj për komente shtesë, veç deshta me i tregu Afërditës qe mamografi mobil besoj që e kuption meqë është e fushës kur të operon në një komunë të caktuar nënkupton se aty është teknika që e bën rendgen mamograf pastaj janë dy apo tre doktor që e përshkruajnë dhe mbi këtë bazë nuk besoj që ka probleme meqenëse edhe z.Durguti tha që kur kanë ardhë ata kanë ushtruar aktivitete për një muaj kështu që Afërdita ajo pjesë nuk paraqet asnje problemë sepse ata vinë komplektë krejt ekipi këtu.

**Kryesuesi – Faleminderit shumë për kontributin, unë i lusë ata të IT-së që për mbledhjen tjetër të rregullohet ai mikrofonë sepse ka mbi një vit që po shkakton shumë telashe. Faleminderit shumë, te nderuar kuvendarë kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:**

### **3. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën janar - shtator 2019, E ftoj z. Afrim Limani!**

**Afrim Limani –** I nderuar kryesues, te nderuar asambleistë, përfaqësues të KFOR-it, një përshtëndetje të veçante për nxënësit e shkollës së mesme dhe për ju gjithë të pranishmit. Kam kënaqësinë që para juve të raportoj, raportin financiar 9-mujorë të komunës së Rahovecit, paraprakishtë të ju informojë se ky raporte është i harmonizuar me Ministrinë e Financave dhe janë të përfshira të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet të cilat kanë ndodhur brenda kësaj periudhe. Ky raport përbëhet prej 3 pjesëve: pjesën e të hyrave, pjesën e realizimit të buxhetit dhe aktivitetet e prokurimit. Unë do të filloj me ju lexua në vija të trasha faqe për faqe në mënyrë që do të jem shumë i shkurtë në mënyrë që të ju japë hapësirë edhe juve të debatojmë edhe të diskutojmë rreth këtij raporti.

Në faqen numër 4, i kemi të prezantuara të hyrat e rregullta, të hyrat e rregullta në këtë periudhë janë 850,809 euro ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë 683,750 euro dhe kur e bëjmë një krahësim atëherë del se kemi një rritje një diferencë pozitive prej 212,059 euro, që do të thotë në raport me planin kemi 97.6% të realizuar ndërsa në raporte me planin në ATK-së është minus 25,767 euro. Në tabelaren e mëposhtme kemi një prezantim të të hyrave duke filluar nga viti 2013-2019 do të thotë në këtë kohë kur raportoj edhe shihet që ky vit është ndër vitet më të mira dhe më të suksesshme sa i përket realizimit të të hyrave.

Në faqen numër 5, kemi të prezantuuar të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut, gjobat e gjykatave në këtë periudhë janë 129,111 euro atëherë në raport me vitin e kaluar kanë një diferencë pozitive prej 34,357 euro ndërsa gjobat e trafikut i kemi 14,945 euro dhe ne raporte me vitin e kaluar kanë një rënje prej 11,204 euro, kur i mbledhim në total të hyrat e rregullta bashkë me gjobat e gjykatave dhe trafikut atëherë të hyrat në total janë 994 368 euro dhe që kanë një diferencë pozitive në raporte me vitin e kaluar prej 190 195 euro.

Ndërsa në faqen 6,i kemi të prezantuara të hyrat sipas llojit të taksave apo sipas kategorive në kode, siç shihet këtu në këtë tabelë diferenca pozitive do të thotë prinë tatimi në pronë që ka një ndryshim prej 89 148 euro.

Duke ditur që të hyrat kryesore të komunës së Rahovecit mbi 40% janë nga tatimi në pronë atëherë ne e kemi prezantuar këtu në faqen 7 një tabelë me disa të dhëna d.m.th. të hyrat e planifikuara ,të realizuara ,numri i certifikatave tjera atëherë del se të hyrat e realizuara në këtë periudhë në tatime pronë janë 371,129 euro që ka një ndryshime pozitivë në raporte me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar prej 90,958 euro.

Në faqen numër 8, kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit sipas kategorive në kuadër të programeve do të thotë paga-mëditje, mallra-shërbime, shërbime komunali, subvencione, transfere, shpenzime kapitale do të thotë buxheti i shpenzuar do të thotë deri në këtë periudhë 9-mujore është 10,433,340 euro.

Ndërsa në faqen numër 9, i kemi të prezantuara shpenzimi i buxhetit në raport me planifikimin sipas kategorive ekonomike, derisa jemi në këtë tabelë desha me dhënë një sqarim te pjesa e subvacioneve dhe transferëve, përqindja e shpenzimit të buxhetit është 455.83%, kjo përqindje siç e dini edhe ju edhe ne të gjithë sistemi Simp i pranon të gjitha të hyrat që regjistrohen në sistem edhe këtu i kemi pjesën e subvacioneve qe e ka ndaje Ministria e Financave përmes subvacioneve për dëmet në bujqësi edhe për këtë është edhe një përqindje edhe me e lartë që përqindja e buxhetit bashkë më këtë është 75.82% atëherë nëse e bëjmë një krahasime te shpenzimet e kësaj kategorie në raporte me planifikimin e që i bien 84% shpenzimit të buxhetit atëherë buxheti në total është i shpenzuar në këtë raporte 67% ndërsa nga faqja numër 10 deri ne faqen 16, kemi të prezantuar të gjitha shpenzimet e buxhetit në kuadër të mallrave dhe shërbimeve sipas kodeve ekonomike ndërsa ne faqen numër 17, kemi një rekapitullim të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike ndërsa në faqen numër 20,i kemi të prezantuar shpenzimi i buxhetit për shpenzime komunali rrymë, ujë, mbeturina, telefon dhe krejt në funde i kemi reportin e zyrës së prokurimit dhe të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar në kuadër të kësaj zyre do të thotë i kemi emërtimin e projekteve, data e nënshkrimit të projektit, afatet për implementimin e kontratës, data e mbylljes së kontratës si dhe çmimi i kontratës. Ju faleminderit për vëmendje dhe presë pyetje nga ju!

**Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për sjelljen e këtij rapporti, po znj.Bajraktari pastaj z. Morina!**

**Florida Bajraktari** – Faleminderit kryesues, e falënderoi drejtorin për prezantimin e reportit finansiar për 9-mujorin e këtij viti, po shkoj si me rend tek faqe 4, realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 kemi ngritur e që është mirë, tek faqe 5 tek gjobat në trafik gjithashtu kemi rritje krahasuar me vitin 2018 ndërsa te gjobat nga gjykatat kemi realizim më të vogël krahasuar me vitin 2018.Tek faqe 6, krahasimi i të hyrave të rregullta sipas kodeve ekonomike 2018/2019 kodi 50026 taksë për legalizimin e objekteve, planifikimi për 2019 ka qenë 38 000 euro ndërsa realizimi është zero dhe për këtë kërkoj sqarim, tek faqe 9, shpenzimet sipas kategorive ekonomike tek kapitalet janë shpenzuar 1,943,511 euro ndërsa janë të planifikuara 4,203,391 euro, a mendoni deri në fund të këtij viti do të bëhet realizimi i buxhetit për këtë kategori gjithashtu faqe 9 në subvencione dhe trasnfere, planifikimi i buxhetit është 250,000 euro ndërsa realizimi është 1,139,589 euro, kërkoj sqarime edhe për këtë dhe krejt në fund i nderuar drejtorë këtij rapporti finansiar i mungon planifikimi dhe realizimi i buxhetit gjinor të cilin e garanton ligji për barazi gjinore nr.05/L-020. Faleminderit për vëmendje!

**Kryesuesi - Faleminderit znj.Bajraktari, urdhëro z. Ali Morina!!**

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, e falënderojmë drejtorin për prezantimin e këtij rapporti, sa i përket realizimit të hyrave konsiderojmë se të hyrat vetanake qoftë të rregullta qoftë ato përmes gjykatës apo gjobave kanë shënuar një rritje të theksuar dhe e përgëzojmë drejtorin për realizimin e këtyre të hyrave po ashtu i pati edhe disa vërejtje edhe në bashkëbisedim edhe me drejtorin pak me parë për disa kategori buxhetore, i mora disa sqarime tash këtu te tabela krahasimi i të hyrave te rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike tatimi në pronë për nga shuma e të hyrave edhe e konsiderojmë shuma me e lartë e arritur deri me tani, po ashtu desha një sqarim më duket disa seanca më përpara kur e kemi pas reportin, një raporte të tillë e ka dhënë drejtori mirëpo nuk jam i qartë, tek kodi 50009 taksa komunale për leje ndërtimi janë të planifikuara 35 euro, realizimi ne vitin 2018, 42 euro kurse për vitin 2019 është 120 euro, me sqarimet qe sa me kujtohet mua që i ka dhënë drejtori në seancat e mëparshme ka thënë që jepet pëlqim ndërtimore nëse nuk gabojë edhe desha me dijtë tash planifikimi i atyre mjeteve në dhënien e këtij pëlqimi a janë në këtë kategori buxhetore apo përfshihen në një kategori tjeter buxhetore edhe me ditë në cilën kategori po hyjnë këto të hyra. Po ashtu kam vërejtje edhe tek inkasimi i të hyrave nga qiraja, nga objektet publike janë të planifikuara 8,000 euro ndërsa vitin kaluar janë inkasuar 690 euro kurse sivjet 1,750 euro që konsideroj se është një inkasim goxha i ulët dhe kërkoj që të rritet aktiviteti për inkasimin e këtyre mjeteve ndoshta qysh edhe operatoret tjerë ekonomikë neve

po na godasin përmes institucionit të Përbashkët ndoshta ka qenë mirë edhe ne pak me shfrytëzua pak këtë institucion për me inkasua mjetet tona.

Çka desha me potencua edhe te realizimi i buxhetit konsideroj se realizimi është duke shkuar në masë të mirë, shpresojmë se do të realizohet sa më mirë që është e mundur, desha tek investimet kapitale më përmend faktin se në shkollën "12 Maji" në Ratkoc është instaluar ngrohja qendrore po ashtu edhe në shkollën e fshatit Celinë që e përgëzoj drejtorin dhe gjithë akterët që janë marrë me këtë çështje për një punë të mirë dhe do të i mundësoj nxënësve që të zhvillojnë aktivitetin mësimore në kushte më të mira. Faleminderit shumë!

**Kryesuesi – Faleminderit z. Morina, z. Cena!**

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, fillimisht falënderojmë drejtorin për Financa për prezantimin e këtij raporti financiar për periudhën janar-shtator 2019, e thanë edhe parafolësit te të hyrat pjesa e të hyrave po shihet se pjesa e të hyrave janë më mirë në krahasim me vitin e kaluar edhe në raporte me planifikimin gjithashtu janë mjaft inkurajuese, sigurisht na gjzon fakti kjo pjesa që është më e qëndrueshme e të hyrave nga tatimi në pronë se ka pasur një rritje në krahasim me vitin 2018, unë vetëm kisha me pyet drejtorin kjo rritje e të hyrave a është ajo pjesa kryesore që ka filluar tatimi në tokë apo janë edhe borgjet që kanë pasur qytetarët më përpara, ai duhet me ditë gjendjen cila është më kryesore që në këtë raste rrit të hyrat. Te faqja 6, krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike, ajo çka bie në sy është disa të hyra nuk kanë kode në pjesën e poshtme të faqes që janë të prezantuara pastaj parafolësit i cekën disa planifikime me realizimin qe nuk korrespondon ose është një diskrepancë goxha e madhe e që mendoj se është një planifikim jo i mirë dhe nëse shkojmë tek kodi 50009 taksa komunale për leje ndërtimi, parashikimi 35 000 , të hyrat vetëm 120 euro ose më poshtë është taksa për ndërrime destinimi dhe shfrytëzimi i tokës fare nuk është planifikuar ndërsa ka të hyra pastaj 5000014 taksa për certifikatat e kurorëzimit, diku planifikimi është i madhe e të hyrat janë të vogla ndërkaq një pasqyrë që unë mendoj se drejtoria duhet të ketë për planifikim është edhe të hyrat nga viti 2018 paraprake, po e zëmë të hyrat kanë qenë te taksa komunale për leje ndërtimi vetëm 42 euro atëherë pse është planifikuar 35 000.e ndërkaq të hyrat janë 120 000 pra kemi të bëjmë me një planifikim jo të mirë dhe nuk e di pse është kjo edhe drejtori duhet me na dhanë përgjigje, edhe kjo shtylla e fundit me përqindje nuk e di pse kjo përqindje me minus është prezentuar, po e zëmë te kodit 40110 tatimi në pronë dhe tatimi në tokë është tejkaluar plani diku këtu ceket 18.69% e në fakte është 118.69% ose nëse diku ka pasur realizim minus 99.50% a nuk do të ishte më mirë të ceket 0.5% ka pasur realizim ose 1% apo 2% dhe jo me shkua me minuse, nuk e di nga këto shifra se paku unë nuk i kam parë më përpara. Tek faqja 9 shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike, më ka rae në sy kjo subvencioni dhe transferi planifikimi është shume më i vogël se sa realizimi, drejtori e ceku është pjesa e dëmeve në bujqësi që është marrë nga grandi qeveritarë, nëse është kjo pra nëse qëndron unë mendoj se do të duhet me qenë sqarimi në këtë tabelë duke qenë se kjo vlerë menjëherë bie në sy edhe ne përqindje 455% do të thotë diçka nuk është në rregull, tabela duhet të jetë me sqarime nëse ka dallime te mëdha. Në faqe 17 mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike është fjala tash për shpenzimet, mua më duket se ka edhe përzimje të kodeve, po e zëmë kodit i parë 13130 është shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit pastaj pak me poshtë rreshti i katërt 13133 shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtarë brenda vendit që kap shifren 14,634 euro, mendoj se ndoshta kjo do të duhej me qenë një kodë sepse kemi të bëjmë me shpenzimet udhëtimit zyrtarë brenda vendit, pse janë dy kode nëse duhet dy atëherë kërkojë sqarime në këtë kodë 13133 në faqe 7, pastaj diku ka mesi kodit 13460, shërbime kontraktuese tjera që kapin shifren mbi 160,000 euro edhe këtë se kam të qartë çka janë këto shërbime kontraktuese sepse është një shumë goxha e majme e parave, pak më poshtë 13,480 shpenzimet për anëtarësim, kjo e kam vërejtur se është bërë nga zyra e Kryetarit 5620 euro nuk e kuqtoj shpenzimet për anëtarësim, për çfarë lloje anëtarësimi është ky që komuna bën shpenzime pastaj më poshtë 13,509 euro pajisje tjera që kushtojnë më pak se 1000 euro e që mbi 50 000 euro kanë kushtuar çka janë këto, në faqen tjetër 18 vazhdim duhet me qenë kjo, gjithashtu në pjesën e sipërme kemi kodin 13620 furnizimi me ushqim dhe pije jo dreka zyrtare dy herë ceket edhe pse është kodi me shifra të njëjtë prezantohet shpenzimi i ndryshëm, ne të parin mbi 6000 kurse në të dytin mbi 5000 pse është kështu, nëse është njëjtë atëherë le të jetë një kodë edhe shpenzimet mblidhen bashkë, mos të bëhet kjo ndarje kështu, kërkojë sqarim edhe këtu, tek

furnizimet mjekësorë po shoh që shpenzimet për këtë vite janë bërë prej 13,000 më shumë, kisha dashtë me ditë nga drejtori apo nga dikush këtu se çka është ble në këtë raste me këto shtesë, çfarë furnizime është bërë në shëndetësi pastaj te kodi 13760 gjithashtu bien në sy blerja e drunjtëve që është një dallim shumë i madhe i çmimit në krahasim me vitin e kaluar gjithnjë, vitin e kaluar ka qenë 6800 kurse tash është 27,000 pra 20,000 është dallim i madhe, tek kodi 1400032 mirëmbajtja e auto rrugëve lokale, kjo është në kuadër të shërbimeve publike gjithashtu është një dallim shumë i madhe i pagesës që është bërë në raporte me vitin paraprakë d.m.th. 22,000 me 92,000 dallimi është 70,000 më tepër për këtë vite, pse ka kushtuar mirëmbajtja e këtyre rrugëve lokale kaq shumë edhe më poshtë kodi 1440010 shpenzimet e vendimeve të gjykatave, gjithashtu ne kemi pasur vërejtje se te gjykata edhe kur është paguar shuma prej 4727000 pse është bërë kjo pagesë ndërkaq tash e kemi dyfishin do të thotë është një pagesë që komuna duhet të ju shmanget pagesave sepse kjo është humbje e parasë edhe tregon efikasitetin e punës së dikastereve qeveritare ndoshta nuk e kryen punën me kohë edhe pastaj po duhet me i paditë komunën në gjykatë atëherë komuna detyrohet me bo pagesën shtesë gjë që nuk është mirë. Tek aktivitetet e prokurimit, kisha me i përmend ja dy apo tre projekte këtu 003 ne fillime hartimi i projekteve të ndryshme, ajo çka bie në sy është një shumë goxha e majme e mirë e parasë 120,000 ka pagina komuna edhe këtu kërkoj një shpjegim do të thotë për çfarë projekte është fjalë sepse unë sa e di edhe komuna e ka një zyrë projektuese për projekte të ndryshme dhe ata njerëz punojnë dhe marrin rroga për atë punë ndoshta marrin mëditje mirëpo kjo a ka nevojë qe komuna me pagina një shumë kaq të majme të parasë për projekte ose së paku cilat janë ato projekte me na sqarua a ja vlen barra qiranë. Tek 026 dhe 027 asfaltimi i rrugës Fortesë-Hamoc-Rahovec edhe ndërtimi i rrugës Xërxe – Sopniq - Ratkoc, kjo u deshtë gjithashtu me na thanë disa fjalë edhe për këto dy rrugë, ne jemi të vetëdijshëm edhe si asambleistë edhe si qytetarë që kanë filluar këto dy rrugë me u ndërtuar, këto dy rrugë nuk kanë qenë të parapamë në Kornizën Afatmesme Buxhetore ose në planin buxhetor d.m.th. unë e di se kam dëgjuar se pagesa bëhet nga niveli qendorë pra investim i qeverisë mirëpo menjëherë e kisha shtrua pyetjen p.sh. se këto para afér 2 milion euro a nuk kish me qenë më mirë qe komuna me i destinua për projekte që unë mendoj janë më prioritare, ne kemi biseduar edhe më herët për çështje të ndryshme prioritare për qytetarët tanë uji i pijes, rrjeti i kanalizimit pra kemi nevoja të mëdha edhe nëpër fshatra edhe në qytete. E kuptoj se buxheti është nga niveli qendor mirëpo unë nuk besoj se niveli qendorë mundet me investua në komuna pa një marrëveshje dhe pa e parë se cilat janë projektet me prioritare edhe në harmoni me qeverinë lokale me Kryetarin komunës e kështu me radhë. Edhe është një kodë më poshtë 038 furnizimi me material ushqimorë, nuk e di për kënd është fjalë edhe këto shpenzime që po bëhen për ushqime, kush po furnizohet me ushqim edhe aty vetëm një sqarim kisha me kërkua edhe tek kodi 023 dhe 049 ne faqen e fundit është transporti lote3, bartja e nxënësve në relacionin Rakovinë – Kramovik nuk e kam të qartë këtë sepse e di që Rakovina nuk është në kuadër të komunës se Rahovecit, pak më lartë është Mrasor-Kramovikë e kuptoj por edhe në të njëjtën kohë është edhe loti tjetër për transportin Rakovinë- Kramovikë kush transportohet edhe kjo është dikun mbi 8000 euro, një sqarim kisha kërkua për ketë. Faleminderit për mirëkuptimin!

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Cena, unë pak më herët e pata në mënyrën kolegiale të mundshme që gjithë kolegët të shfrytëzojnë të drejtën e tyre të diskutimit deri në 3 minuta pastaj shefat e grupeve deri ne 6 minuta, urdhëro z. Durguti e ka kerkuar fjalën, ndoshta drejtori po mundet me mbërrri me i shënuar për me pas parasysh që me mujt edhe me mbërrri edhe për shkak të përgjigjeve, urdhëroni z.Durguti! Vazhdim i pjesës së dytë!

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për një raport mjafit të mirë dhe informues për të gjitha kategoritë dhe aktivitetet ekonomike që kanë ndodhur në këtë periudhë raportuese, unë e kam vetëm një pyetje në faqen numër 4 në tabelën 1.2 Të hyrat vetanake të realizuara në bazën mujore 2018/2019 dhe krahasimi i tyre, ajo që më bie në sy është muaji shtator i këtij viti planifikimi ka qenë 97,397 euro ndërsa realizimi 132,000 euro do të thotë që realizimi e tejkalon në një masë të madhe planifikimin ose këtë realizim e krahasojmë me periudhën raportuese te vitit 2018 në shtator atëherë po shohim se në shtator të vitit 2018 kemi pasur realizim 66,711 euro d.m.th. e tejkalon dyfishin e realizimit te muajit shtator të vitit 2018, a ka mundësi drejtori me na dhanë një sqarime çka ka ndodhur që kanë inkasuar kaq shumë mjete të muajit shtator të këtij viti. Ju faleminderit, nëse ka ndonjë informatë.

**Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Durguti!**

**Fahrie Lushi** – I nderuar kryesues, të nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit. Të një natyre të tillë sikur kjo me ngrijen e shifrave është edhe kodi 50409 që përfshinë participimet te Bujqësia, janë të planifikuara për 2019, 8500 euro ndërsa janë të realizuara 78,442 euro, mendoj se edhe kjo e kërkon një sqarim shtesë. Faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit zj. Lushi. po urdhëroni z. Ali Zhuniqi!**

**Ali Zhuniqi** – Meqenëse shumica i përmenden, unë dua të ndalem vetëm të disa kode edhe konkretisht te mallrat dhe shërbimet 3.3 faqe numër 10 kodi 13440 shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënese, konkretisht te Kuvendi Komunal kur është bërë një shpenzime prej 3050 euro, nëse kish mundësi me na sqaruar në lidhje me arsyeshmërinë e këtij shpenzimi pastaj kemi te kodi 13509 faqe 13 ku kodi thotë që pajisjet tjera me pak 1000 euro ndërsa tek shërbimet publike është një shumë e cila është 26,892 euro, tjetër faqe numër 14, kodi 13140 shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, nuk e di si mundet me u realizua një udhëtim zyrtar jashtë vendit me 52 euro qysht nënkuption kjo unë këtë nuk e di, edhe për këtë në të njëjtën faqe, kodi 13133 shpenzimet e tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit, kemi një shume prej 14,634 euro, e ftoj drejtorinë e arsimit të na jep arsyeshmerinë e këtij lloji të shpenzimit edhe tjetër mirëmbajtja e objekteve shëndetësore faqe 16 kodi 14024 nëse e krahasojmë me vitin e kaluar te shpenzimet për mirëmbajtje të objekteve shëndetësore kemi një diferencë diku 21,300 euro a nënkupton që kjo ende nuk janë realizuar pagesat e operatorëve apo pse ka ndodhur kjo lloje ndryshimi i diferençës sa i përket shpenzimeve, njëjtë është edhe tek mirëmbajtja e shkollave kemi një diferençë dikur prej 20,200 krahasuar me vitin e kaluar, besoj që drejtori është duke shënuar këto, edhe në fund krejt te numri i brendshëm i prokurimit konkretisht faqe 21 kodi 007 kryerja e shërbimit medial për komunën e Rahovecit ri- tenderim 8,950 euro edhe shërbime tjera të transmetimit të kuvendorit dhe shërbime tjera për komunën e Rahovecit 5,394 euro, nëse këto dy shërbjejnë për cilindo qofshin këta operatorë që neve na monitorojnë dhe që kanë të drejtën e këtyre shërbimeve, të paktën duhet që të pajisen meqenëse marrin shërbime prej komunës duhet të pajisen me kamera profesionale në mënyrë që neve të na transmetohet zëri direkt tek qytetarët e komunës së Rahovecit në mënyrë që te kemi transparencë sa me shumë karshi qytetarëve. Ju faleminderit! 10:06:19

**Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Zhuniqi, drejtor unë po shpresoj qe keni mundur t'i shënoni të paktën një pjesë të diskutimeve të kuvendarëve, ju kisha lutar nëse mundeni me ju dhanë sqarimet që pothuajse janë të përfshira të gjitha materialet.**

**Afrim Limani** – Paraprakisht kërkoj falje ndoshta s'kam mundur me i shkruajt të gjitha pyetjet që më keni bërë mirëpo unë e hapi mundësinë edhe të një bisede interaktive, s'kam mundur drejtorit me ia regjistruar të gjitha pyetjet gjithashtu edhe Alisë, po ashtu edhe Florida i ka bërë disa pyetje mirëpo pyetjet e saj lidhen edhe me pyetjet pasuese që i kanë bërë deputetet. Po e fillojë te Alia, taksa për leje ndërtimore, pse ka një mospërputhje mes planifikimit dhe realizimit të dy lloje taksave, unë do t'i jap një përgjigje kështu që le hapësire me kuptua edhe të tjerët e që në fakt taksa komunale për leje ndërtimi është edhe taksa e inspektimit të respektimit të planit urbanistikë janë të hyrat kodet që janë në kuadër të drejtorisë se Urbanizmit. Në inspektimin e respektimit të planit urbanistik kemi një realizim prej 9,356 euro ndërsa te taksa komunale për leje ndërtimore i kemi 120 euro, çka është kjo e realisht krejt këto të hyra të cilat janë në kuadër të këtij kodi do të thotë inspektimi i respektimit të planit urbanistik janë të lejeve ndërtimore dhe për atë edhe e kemi bërë planifikimin atje mirëpo tash ka ndodhur kjo në kuadër të drejtorisë se Urbanizmit ata i kanë dy blloka edhe vazhdimisht në njërin bllok i kanë regjistruar këto të hyrat nga inspektimi i respektimit të planit urbanistik e në fakt me leje ndërtimore jo mirëpo me rendësi është që këto të hyra janë në kuadër të kësaj drejtorie edhe realisht i takojnë lejet ndërtimore pastaj këtu janë edhe disa defekte tjera që shumë sinqerisht po ju them është në raporte me mos planifikim i kemi taksa për ndërrimin e destinimit të tokës, taksa për certifikatën e kurorëzimit dhe taksa për certifikata tjera ofiqarë, do të thotë krejt këto janë disa defekte të cilat janë bërë në planifikim të buxhetit dhe në buxhetin e vitit 2020 ju them sinqerisht edhe do t'i dërgoj edhe një material me gjithëse e keni por e kam përpunuuar prapë që këto taksa do të rregullohen edhe do t'i përket secila lloj takse drejtorisë përkatëse sepse deri me tash ka pasur njëfarë mospërputhje të këtyre do të thotë projektet janë këto

të cilat ju thashë do të thotë me rëndësi është ne më pas të hyra pak rendësi është se ku gjendet ajo taksë mirëpo e rëndësishme është ne me pas të hyra mirëpo në të ardhmen nuk do të ketë probleme të kësaj natyre. Te evidentimi i kodeve, doktori e potencoje do të thotë ky është edhe një lëshim teknik që kemi harruar, që vazhdimisht po e bëjmë sikur ta kishim diskutuar në komitet, me siguri e kishim përmirësuar. Doktori bëri këto pyetje, rritja e të hyrave te tatimi në pronë është nga toka dhe pse është kjo rritje apo nga borgjet, si informatë doktor si informatë ta keni do të thotë te hyrat nga toka nuk kanë filluar sivjet së aplikuari mirëpo nuk besoj që edhe vitin ardhshëm do të fillojnë mirëpo presim më vonë në fazë të mëvonshme ndonjë njoftim paraprak nga Ministria e Financave a do të fillojë apo jo mirëpo me rëndësi këto të hyra nuk janë nga toka por janë nga tatimi në pronë dhe pse janë kaq të mëdhaja, është shumë e vërtetë që janë kaq të mëdhaja në krahasim me vite të tjera se janë edhe faktorë tjerë që kanë ndikuar mirëpo ne planifikimin po e kalojmë e që në fakte edhe një pjesë të borgjit po e mbledhim.

Arsyeja pse unë e konsideroj që është një vetëdijesim më i madh i qytetarëve e tash s'po dua me lanë meritat me angazhimin tonë mirëpo unë e shoh këtu kryesisht një vetëdijesim me të madh të qytetarëve edhe qytetari po e din që e ka obligim edhe vjen e paguan tatimin. Taksa komunale për leje ndërtimore por edhe leje urbanistike mendoj që unë e dhashë shpjegimin edhe pjesën tjetër doktor nuk kam mundur me regjistrua edhe mbetet hapësirë me ty interaktivë edhe lirishtë mundeni me bo pyetje. Te pjesa e shpenzimit të buxhetit për subvencione do të thotë është dashtë me dhanë sqarime, këtu pajtohem me ty n'fakt është dashur një aneksë me dhënë një sqarim ashtu siç raportova edhe më parë do të thotë pjesa e buxhetit në kuadër të subvencioneve në Bujqësi prej 927,959 euro janë pikërisht pjesa e mjeteve që i ka dedikuar pra i ka ndarë Qeveria për kompensimin e dëmeve në Bujqësi edhe çdo mjet i cili hynë në sistemin Simp, ne duhet patjetër që atë me regjistrua gjenerua edhe ai del prandaj edhe thash edhe në fillim se raporti është i harmonizuar edhe i barazuar me Ministrinë e Financave. Te shpenzimet kontraktuese tjeta janë disa shpenzime, pra kam pritur që do të kem këtë pyetje edhe pse ka një dallim të madh në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar te pjesa e shpenzimeve te kodi shpenzimet kontraktuese tjeta. Në kuadër të këtij kodi, kemi një shpenzim prej 116,397 euro edhe kush hyn në këto shërbime kontraktuese tjeta janë Agjencioni i Zhvillimit Rajonal Jug, ( AZHRJ ), që e kemi për obligim me ja pagua një antarësi prej 5000 euro pastaj e kemi Caritasin që kemi një kontratë prej 10,000 euro, Vizioni i Rinisë - Anadrinia Jehon që i kemi ndarë me vendim të kuvendit 5,500 euro pastaj e kemi, rrënimini pa leje qe kemi ndarë 7,863 euro për shkak se e kemi diskutuar edhe në raporte tjeta financiare për shkak të keq klasifikimeve që auditori i ka gjete si keq klasifikim atëherë ne edhe planifikimin e kemi bërë për buxhetin vitit 2020 në mallra dhe shërbime edhe pagesën do të thotë për këtë vit e kemi kryer prej pjesës mallra dhe shërbime pastaj i kemi 30,000 euro shpenzim, n 'fakt ne kemi dështuar me realizua një kontratë me kompaninë që mirët me mirëmbajtjen e objekteve të komunës, realisht ai dështim ka zgjatur deri në 5 muaj edhe ne jemi detyruar me pagua punëtorët të cilët e mirëmbajnë objektin si në komunë ashtu edhe në shëndetësi edhe diku janë përafërsisht 20 punëtorë edhe ata jemi detyruar me i pagua ne si komunë për paga nga pozicioni mallra dhe shërbime dhe kjo vlerë ka arritur vlerën diku 30,000 euro pastaj pjesa e mbetur është kontrata mbi vepër që kemi pasur edhe i ka drejtoria e Bujqësisë disa puntorë i ka edhe drejtoria e Financave, muaji i mërgimtareve, shtesa në Bujqësi edhe tjerë e krejt këto kanë ndikuar me rritë këtë vlerë. Doktor, kërkoi falje që skam mundur me i regjistrua të gjitha, në mundemi me bo edhe bisedë edhe interaktiv, një pyetje edhe tek pjesa e raportit të Zyrës së Prokurimit më duket që keni bërë edhe nje pyetje, Hartimi i projekteve do të thotë 120,000 kontrata u lidhë me atë vlerë mirëpo kontrata është me njësi, nuk do të thotë sa njësi bëhen do të thotë operatori aq edhe paguhet. Tash shtrohet pyetja pse në në investime kapitale, me ligje të financave publike dhe përgjegjësive do të thotë një projekte edhe pse në shikim të parë duhet me i takua kategorisë mallra dhe shërbime mirëpo ai hyn në investime kapitale sepse për atë vlerë e rrit vlerën e projektit, nëse një kompani e ka hartuar një projekt po supozojmë në rrugë, krejt ajo vlerë që duhet me pagua kompaninë ajo i shtohet asaj rrugë do të thotë e ngritë edhe vlerën, do të thotë duhet me qenë edhe në kuadër të investimeve kapitale. Munibi e ka bërë një pyetje interesante, çka ka ndikuar në të hyrat e muajit shtator që janë më të mëdha në raport me vitin e kaluar edhe i ka tejkalua planifikimin. Në e kemi nxjerrë nga planifikimi totalë që e kemi prej 1,168,000 euro mesatarja për çdo muaj ka dalë 97 000 euro kështu që muaji shtator ka qenë si një

ndër muajt ma të mirë sa i përket inkasimit të hyrave dhe pyetja juaj edhe mua më ka interesuar kjo edhe isha kureshtare me ditë pse, sepse është muaji i fundit kur me ju ikë ndëshkimeve dhe gjobave edhe qytetarët paguajnë mirëpo pjesa më e madhe ka ndikuar prej operatoreve ekonomikë do të thotë prej bizneseve të ndryshme që janë të rregullta dhe vazhdimisht edhe është periudha e fundit edhe ata për me i shlye borgjet që mos mu ngarkua edhe me kamata e kanë bërë edhe shlyerjen e borgjeve.

Fahria e bëri një pyetje pse të hyrat nga Bujqësia janë me të mëdha në raporte me planifikimin do të thotë te participimet, më thënë të drejtën këtu nuk kemi mundur të qëllojmë saktë vitin e kaluar kur e kemi bërë buxhetin do të thotë pa u kryer ky proces atëherë jemi shkuar me një lloje mesatare që duhet të ishte kaq mirëpo kjo është e mirë që kemi ndoshta trefishë apo pesëfish të inkasimit të hyrave ne raport me planifikimin që e kemi bërë mirëpo tash planifikimet e ardhshme ndoshta nuk ja qëllojmë për pak për minus 10 apo plus 10% kjo është arsyaja, sepse për herë të pare kemi filluar të inkasojmë një të hyrë nga participimi në bujqësi. Për Alien s'kam mundur me i regjistrua pyetjet por besoj e kam më lehtë se mundemi me bo edhe interaktiv, sinqerisht kërkoj falje, i bëre disa pyetje në pjesën e shpenzimeve në mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike, tek shërbimet këshillëdhënëse në kuvendë, pse është kjo do të thotë ne KKSBB-në e paguajmë nga mallra dhe shërbime në kuadër të kuvendit, pra pagat mëditjet që i marrin ata, ne kuadër të mallrave dhe shërbimeve në kuadër te kuvendit pra vetëm këtë pyetje kam mundur me regjistrua. Në fakt planifikimin e buxhetit zakonisht në kuadër të zyrës së Kryetarit dhe shërbimeve publike ne fakte e bëjmë një planifikim më të madhe sepse përmes kësaj zyrë mundemi me pagua edhe shpenzimet e tjera, tash rasti konkret unë nuk e di se për çka është fjala por mundem me than në kuadër të shërbimeve publike e kemi, nuk e di ç'farë shpenzime janë bërë, e kemi të koncentruar më shumë në shërbime publike edhe thjesht për momentin nuk po e di çfarë shpenzimi kemi bërë. Bartja e nxënësve që ne i kemi 3 apo 4 kontrata që bëjnë bartjen e nxënësve pikërisht prej shpenzimit të buxhetit shkon në kuadër të këtij kodi, do të thotë kjo ndërlidhet me bartjen e nxënësve që kemi bërë ama emërtohet ndoshta tingëllon me ndryshe mirëpo regjistrohet në kuadër të këtij kodi do të thotë e kemi bartjen e nxënësve që e bëjmë, tash mu kujtua edhe një pyetje që e bëri doktori më herët pse ne me i bartë nxënësit prej Rakovine ne Kramovik, doktor ne ata nxënës që vijnë prej Rakovine në Kramovik në shkollë, e Kramoviku është e komunës tonë, te them të drejtën ne e kemi gjetur edhe më herët këtë kontratë edhe e kemi trashëgua vazhdimisht për interes të nxënësve.

**Sali Sallteku** – Për hir të sqarimit të doktorit, kjo është interes i komunës tonë, ne kemi pasur të njëjtin problem me nxënësit e Retisë së goranëve atje, ata kanë këruar me ju pagua udhëtimin për me shkue në Piranë kurse ne ju kemi thënë se ne ju paguajmë udhëtimin nëse vini këtu se kështu është interes i komunës, edhe me punëtorë kjo ka qenë interes shumë i hershëm sepse Rakovina vazhdimisht ka qenë në Kramovik edhe është interes i komunës tonë edhe nuk ka kurrgjë të keqe këtu. Faleminderit!

**Kryesuesi** - Faleminderit z.Sallteku, ndoshta drejtori është duke mbërri ka fundi i përgjigjeve për ti dhëne sqarimet, urdhëroni drejtor!

**Afrim Limani** – Po e di edhe këtë shpenzim, një punëtor i drejtorisë së urbanizmit ka pasur një seminar në Shqipëri më konkretisht dy ditë sa e di unë edhe shuma e mëditjes për një ditë me sa e di unë 25 euro, edhe kjo është arsyaja e shpenzimit pra një e drejtë që i takon me ligj. Ne e kemi një kontratë me një kompani e cila na furnizon me material higjienik sanitari edhe pikërisht është kjo kontratë edhe deri në këtë periudhë i kemi mbi 30 shkolla edhe ndoshta shume e logjikshme është që të jetë edhe ky shpenzim, ky kod ndërlidhet edhe me atë. Në 07 është kryerja e shërbimeve mediale për komunën e Rahovecit n 'fakt ne jemi të detyruar edhe me ligje bëjmë edhe oferta të hapura edhe të konkurrojnë kompanitë të cilat merren pra i kemi aty konkurset, shpallje të ndryshme në kuadër të komunës ndërsa 021 shërbimet e transmetimit në kuadër shërbimeve tjera të komunës se Rahovecit është kjo kompania që po na qet në televizor edhe tash edhe që lidhet ekskluzivisht me këtë.

**Kryesuesi** – Drejtor faleminderit shumë për të gjitha këto sqarime me gjithë këto informata, mendoj që drejtori ka mundur me mbërri me marr shënimë për të gjitha ato që i parashtruat, ju ndoshta nuk ka mundur të merren të gjitha sepse është ndryshe është kur të flasësh e ndryshe kur të shkruan që për ndonjë kod ka mundur edhe të ikë dhe të mbetet pa përgjigje dhe sqarim por nëse edhe për diçka për do informata tjera shtesë mundësisht ne mundemi me kontaktua edhe te drejtori atje se vërtet nëse bash kërkojmë që e gjitha sqarimet

këtu atëherë do të jemi deri në mbrëmje do të rrimë për secilin kodë, në kemi edhe pikë tjetër të rendit të ditës por sido që të jetë doktor ne jemi edhe kolegë ne mundemi prapë me ju dhanë fjalën, por duhet të kemi konsideratë, urdhëro doktor!

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, faktë unë çdo herë po përpinqem që të jem i shkurtë edhe po e marr parasysh rendin e ditës, sot nuk e kemi shumë të ngjeshur edhe nuk besoj që vonohemi shumë pastaj disa pyetje që bëra unë, nuk pata përgjigje edhe drejtori tha që mundemi me bo interaktiv u morëm vesh pak ndryshe, nuk është problem unë pata veq dy apo tre sende me i sqarua d.m.th. është një çështje që mundet të përsëritet, është në kuadër të drejtorisë për Financa dy kode me shifër të njëjtë, kjo ishte vërejtja ime pra është ndaje faqe 18, furnizimi me ushqim dhe pije edhe shifrën e kanë të njëjte 13620 është ndaje shume në 6000 dhe 5000, a duhet kjo kështu të ndahet dhe pse me u nda kam pyetur, pastaj me ka ra në sy kjo mirëmbajtja e rrugëve lokale ndoshta ai vetëm i përshkruan këto shpenzime është kjo drejtori e Shërbimeve Publike atë shpenzim në 22.000 në 2018 dhe 92.000 në 2019, një sqarim këtu e kërkova është një dallim i madhe pra janë në pyetje 70,000 euro pra faqe 18, pra këto dy pyetje nëse ka përgjigje së paku për të parën rrith kodeve. Faleminderit.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Cena, atëherë drejtor nëse keni mundur me gjet ku është ajo, ju kisha lutur për një sqarim.

**Afrim Limani** – Pjetja parë ishte pse shpenzimi me një kodë të njëjtë me një emërtim 13 620. Këtë kodin e dyte aty shkruan 21 që janë të hyra vetanake, ky shpenzim është bërë në kuadër nga buxheti i të hyrave vetanake e jo nga grandi pra nuk është shpenzuar nga grandi, ne kemi mundur me rritë këtë vlerë 5611 në kuadër të një kodit për transparencë e kemi bërë do të thotë edhe ky shpenzim i buxhetit është nga të hyrat vetanake nga 21. Sa i përket kodit tjetër të mirëmbajtjes se rrugëve edhe pse ka një dallim të madhe në raport me periudhën e vitit të kaluar, se pari në këtë vite ne i kemi rritë shpenzimet e pastrimit, ne krahasim me vitin e kaluar sivjet kemi edhe pastrimin e varrezave edhe rrugëve edhe e kemi shtrirë rrjetin jo në një rrith me te ngushtë por në tërë territorin e komunës së Rahovecit edhe një sende këqyre ne fund të tabelës buxhetit është i shpenzuar me i madhe në raporte me vitin e kaluar do të thotë deri në këtë periudhë nuk e kemi lanë asnjë obligime në pritje në kuadër të mallrave dhe shërbimeve do të thotë faturat të cilat kanë ardhur ne i kemi ekzekutuar pra nuk kemi pasur obligime në pritje dhe për këtë është rritë buxheti në të gjitha kategoritë të këtyre kodeve ekonomike edhe kjo është një arsy me madhe.

**Kryesuesi** – Drejtor faleminderit shumë, të nderuar kuvendarë tanë kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

#### 4. Shqyrtimi i Informatës së DKA –së për fillimin e Vtitit të Ri Shkollorë 2019/2020 –

**Avni Morina** – Përshëndetje edhe njëherë për të gjithë, ne radhë po e lexoj informatën e DKA-së për fillimin e vtitit të ri shkollorë 2019/2020, zakonisht përgatitjet për fillimin e vtitit të ri shkollor bëhen gjatë muajve të verës korrik dhe gusht. Drejtoria Komunale e Arsimit në fillim të muajit gusht e ka analizuar me kujdesin më të madhe gjendjen personelit mësimor në të gjitha shkollat e komunës sonë duke bërë një planifikim dhe risistemim të kodit mësimor sipas profileve mësimore në të gjitha nivelet duke filluar nga niveli para fillor e deri te niveli i mesëm i lartë. Si rezultat i planifikimit të bërë, kemi pasur edhe një konkurse për plotësimin e vendeve të lira të punës në disa dispozicione në shkollat e komunës, shumica e të cilave ishin zëvendësime pra pozita me kohë të caktuar. Drejtoria Komunale e Arsimit ka marr të gjitha masat që procedura e konkursit të shkojë mirë duke respektuar të gjitha afatet ligjore dhe udhëzimeve administrative të MASHT-it. Ky konkurs u hapë në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ të fundit 10/2018. Gjatë muajve të verës u mbajtën dhe një varg trajnimesh me arsimtarët të fushave të ndryshme me arsimtarët e mësimdhënës të fushave të ndryshme korrikulare të cilat ishin të nevojshme për ngritjen dhe përgatitjen edhe më të mirë profesionale të mësimdhënësve tanë. Ne fund të muajit gusht, nga Ministria e Arsimit kemi pranuar të gjitha librat, tekstet shkollore për klasat 1-9-të të cilat fillimisht i kemi vendosur në pikën grumbulluese dhe pastaj i kemi shpërndare në të gjitha shkollat e komunës sonë. Fillimi i vtitit të ri shkollor si mbarë Kosovën edhe tek ne ishte me 2 shtator, ditë e hënë dhe që në fillim të gjitha shkollat fillore të mesme të ulët të komunës tonë ishin të pajisura me tekste shkollore mirëpo kemi disa tekste të rënda të Kimisë dhe Artit figurativë për klasat e shtata të cilat Ministria e Arsimit i ka vonuar dhe ende nuk janë shpërndarë.

Drejtoria Komunale e Arsimit i ka grumbulluar të gjitha kërkuesat e shkollave për lëndë djegëse që do të përdoren për ngrohje gjatë muajve të dimrit dhe furnizimi është bërë në shumicën e shkollave përvèç dy shkollave të cilat do të furnizohen shumë shpejt. Në bashkëpunim me zyrën e prokurimit jemi përkujdesur edhe për procedurat e prokurimit për lyerje dhe mirëmbajtje të shkollave por për arsyet e zgjatjes së këtyre procedurave ka pasur vonesa në realizimin e kontratave për lyerje dhe mirëmbajtje të objekteve shkollore siç ishte rasti me shkollën filllore në Xerxë. Kemi filluar dhe është bërë gati në përfundim realizimi i projektit për instalimin e ngrohjes qendrore në tre shkolla të komunës, në shkollën e mesme të lartë "12 Maji" në Ratkoc, në shkollën filllore të mesme të ulët "Sopniqi" në Sopniq, në shkollën filllore të mesme të ulët „Faik Konica“, në Celinë ndërsa në ndërkohë ka filluar projekti i eficiencës së energjisë në shkollën filllore te mesme të ulët „Vëllëzerit Frashëri“, në Drenoc.

Shkolla "Milaim Krasniqi" në Pastasel është po ashtu në programin e eficientësh së energjisë dhe e kemi marr konfirmimin nga MZHE -ja që së shpejti do të nisin procedurat e prokurimit për realizimin e këtij projektit dhe projektit në shkollën e Nagavcit për vitin 2020 është fjala, gjithashtu gjatë muajve të verës ka vijuar të realizohet edhe pothuajse është në përfundim edhe drenazhimi dhe hidroizolimi edhe i dy shkollave, ka përfunduar shtrimi i dyshemeve në shkollën filllore të mesme të ulët „Dëshmoret e Lirisë“, në Potoqan të Poshtëm dhe është kryer rrethoja e shkollës së mesme të lartë „Xhelal Hajda – Toni“, në qytet. Ka vazhduar ndërtimi i objekteve shkollore në Hoçë të vogël –Brestovc, në Retijë, ka vazhduar ndërtimi i çerdhes në Ratkoc dhe presim që në fund të muajit nëntorë të përfundojnë të gjitha punimet e çerdhes në qytete dhe të jetë e gatshme të presë fëmijët e moshës parashkollore, pastaj 12 shkolla të komunës tonë kanë vazhduar zbatimin e projektit të fituara nga Banka Botërore në kuadër të të cilave janë bërë disa furnizime me pajisje laboratorike dhe teknologji informative. Gjithashtu DKA-ja ka kryer furnizime me pajisje të teknologjisë informative në disa shkolla ku janë furnizuar me kompjuter dhe Smart TV. Në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Kulturë Rini dhe Sporte kemi lidhur një kontratë për furnizime me libra të bibliotekave të disa shkollave me ç'rast gjatë javëve të fundit kemi shpërndare libra në 5 shkolla të komunës sonë, në shkollën Isa Boletini, në shkollën e Sopniqit, në shkollën në Potoqan të Poshtëm, ne shkollën në Pastasel dhe në shkollën e Denjit.

Me keqardhje me duhet të ju them se trendi i rëniës së nxënësve edhe këtë vite është shumë i madhe kështu sipas evidencave të nxënësve të regjistruar në këtë fillim të vitit shkollorë në shkollat filllore dhe të mesme nga klasa e parë deri në klasën e dytëdhjetë gjithsej në nivele komunë në këtë vite shkollorë kemi 410 nxënës më pak.

Zvogëlimi i numrit të nxënësve ka shkaktuar probleme sepse ka shkaktuar në zvogëlimin e numrit të klasave dhe për pasoje edhe zvogëlimin e numrit të mësimdhënësve. Në kemi qenë edhe jemi vazhdimisht në kontakte përhershëm edhe në vizita në shkolla dhe sipas të dhënave që kemi procesi mësimorë ka filluar mbarë në të gjitha shkollat. Drejtoria komunale e Arsimit ka bërë gati një planë me një vargë aktivitetesh dhe fillimisht kemi zhvilluar vizitat e zyrtarëve të DKA-së në të gjitha shkollat, vizita të tilla nëpër shkolla do të janë vazhdimisht sepse synojmë se sistemi arsimorë të komunës tonë të ngrisim në nivele më të lartë që siguron arsim cilësore.

Brenda kësaj periudhe që kur e kam nxjerrur informatën se informata është nxjerrë me datën 9.10.2019, kanë ndodhur edhe dy zhvillime të tjera, deshta të ju informoj se nuk i keni të shkruara në këtë informatë, ka qenë një kërkësë edhe prej asamblistëve që në kuadër të DKA-së të formohet ekipi për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve dhe këtë ekip e kemi themeluar javën që shkojë, gjithashtu e kemi themeluar edhe një ekip tjetër profesional për vlerësim dhe mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjithashtu desha të ju informoj se kemi fituar një projekt nga Caritasi i Zvicrës në menyrë që 6 klasat parashkollore të i pajisim me inventarë, në shkollën e Drenocit, Senocit, Xerxës, Zatriq, Ratkoc dhe Potoqan të Epërm.

**Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për informatën, po z. Masar Popaj!**

**Masar Popaj** – Përshtendetje për të gjithë, drejtori na bëri një informatë por kësaj informate i mungojnë shumë gjera. Drejtoria DKA –së na dha një informatë por në këtë informatë nuk pashë të dhëna numri total i nxënësve, numrin e arsimtarëve në këtë informatë duhet me pas numrin nxënësve të vitit të kaluar dhe numrin e nxënësve për këtë vite dhe pastaj të ceket numri i nxënësve që është më pak se në vitin e kaluar që e ceku

410 nxënës me pak, ka mundësi që të jetë edhe numri më i madhe i nxënësve që është më pak, po ashtu nuk është cekur sa paralele janë në të gjitha shkollat si dhe sa shkolla janë në komunën tonë ,unë desha të marr numrin e nxënësve edhe të arsimtarëve në totalë dhe të bëjmë një pjesëtim e nxënësve me arsimtarëve dhe të shohim sa nxënës i bien për kokë arsimtari, kështu që kam informata të sakta që në një paralele në klasën e 9-të janë vetëm 3 nxënës, aty diku 30 orë i jepin arsimtarët dhe që i bie 2 arsimtarë për 3 nxënës të marrin dy paga, kështu që kam informata prej klasës së parë deri të pestën shkon një paralele që i ka diku 24 nxënës kurse kur dalin në klasën e gjashtë ndahen në dy paralele vetëm për të ju krijuar vende punë, kështu që unë desha një sqarim nga drejtori për pyetjet që ja bëra. Faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Popaj, po urdhëroni znj. Lushi!**

**Fahrie Lushi** – Faleminderit kryesues, unë do të ndërlidhesha ose thjeshtë pyetja ime për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit shkon në një drejtë se pse është marrë Drejtoria e Arsimit ndonjëherë në komunën tonë me çështjen sepse pse nxënësit ose një numër i konsiderueshëm nga komuna jonë ikin dhe shkojnë në komuna tjera p.sh. në Prizren apo në Gjakovë, mbi të gjitha duhet të studiohet cilësia e mësimdhënies që mbahet në këto paralele e sidomos në paralelet e mesme të larta, te përfshihet edhe përvoja e punës mbi të gjitha a i plotësojnë kushtet ata mësimdhënës në këtë cikël të mësimdhënies sepse me sa e di ka edhe të tillë që nuk i plotësojnë kushtet e janë mësimdhënës në shkollat e mesme të larta. Pra unë mendoj se këtu duhet të jetë qasja nga drejtoria e Arsimit e jo të marrim ato statistikat që i ka përmendë në gjithë raportin ose në gjithë informatën, janë të mira mirëpo e rëndësisë së parë është të merremi me cilësinë në arsim sepse ku është cilësia e arsimit në komunën tonë e madje t'i përvishemi atyre çështjeve tjera që besoj janë më pak ndoshta të rëndësishme se kjo. Faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit znj. Lushi!**

**Besa Bytyqi** – Faleminderit kryesues, edhe unë dua të falënderoj drejtorin për informacionin ndërsa meqënëse jemi te kjo pikë kerkoj nga drejtoria e Arsimit nga të gjithë mësimdhënësit e sidomos mësimdhënësit e gjuhës shqipe që të gjunjë ndonjë mënyrë për të rritur lexueshmërinë e librave nga nxënësit në të gjitha shkollat, ne të gjitha nivelet. Ndoshta fillimisht leximi i obligueshëm i një libri në muaj edhe bashkëbisedimi për atë libër i nxënësit me arsimtarin pra mësuesit e gjuhës shqipe do të ishte një fillim i mbarë për të ngritur këtë lexueshmëri, pra kjo çështje vërtetë mua më preokupon shumë duke parë që niveli i leximit ka rënë shumë në nivel vendi edhe në komunën tonë ndërsa me librat që i keni ndarë në disa shkolla ditëve të fundit, unë kerkoj që të shpërndahen në të gjitha shkollat edhe në të gjitha bibliotekat e shkollave e në këtë raste fokus të veçantë e kam Opterushën pra shkollën fillore në Opterushë e për aty kerkoj edhe një kënd leximi pra një kënd ndoshta do të inkurajonte sadopak nxënësit të lexonin aty dhe të bashkëbisedonin për libra të caktuar. Faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit shumë znjsh. Bytyqi!**

**Mirjeta Krasniqi** – Faleminderit kryesues, pëershëndetje për të gjithë kolegët këshilltarë, unë vetëm desha të ndërlidhesha kur shefi grupit kerkoi më tepër sqarime e kerkoi kur nxënësit nga Rakovina i paguajmë me i sjellë në Kramovik, unë kerkoi që këtu ne biem në kundërshtime që ne nxënësit tanë nga Guri i Kuq, Kramoviku, Nushpalla na shkojnë në Gjakovë d.m.th. sa po humbim edhe sa po përfitojmë, unë e di se nxënësit në shkollën e mesme nuk mundesh me i obligua me i sjellë por kur shkollat e njëjta i kemi në territorin e komunës tonë por shkojnë në shkollat e profilit të njëjtë në Gjakovë. Unë kisha kerkua nga drejtoria e Arsimit të sigurohet udhëtimi për këta nxënës dhe t'i sjellim në shkollat në territorin e komunës tonë pasi që po humbim rreth 60 nxënës që po shkojnë në "Hajdar Dushi" në Gjakovë, ne mundemi me i sjell lirisht këta me një mjet transporti. Faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit shumë znj. Krasniqi!**

**Rukije Krasniqi** – Faleminderit kryesues, unë desha me i ardh në ndihmë zbatimit korrikularë në lëndët mësimore sidomos të shkencave, të pajisen edhe me ilustrime minimumi i ilustrimeve le të jenë ato e mos të flasim për mjete ilustruese tjera kështu që le të përpushten edhe ilustrimet me tekstet shkollore sepse ilustrimet e kaluara nuk i vijnë shumë në ndihmë korrikulës të cilën ka pësuar plan programi mësimorë. Ju faleminderit!

**Kryesuesi – Faleminderit shumë znj. Krasniqi!**

**Ali Zhuniqi** – Faleminderit drejtorit për informatën, unë kisha vetëm një kërkesë konkrete, sa e pashtë unë kontrata përfundimin ose pranimin teknik te ndërtimi i shkollës ka me përfunduar diku 2022, një kërkesë konkrete për drejtorin për shkollën fillore “Liria” në Fortesë, i kam kërkuar vazhdimisht që të bëhet lyerja e shkollës brenda sepsë nxënësit janë në myk, kisha preferuar shumë më shpesh me vizitua atë shkollë, unë isha në zgjedhjet e fundit, e kam parë që është një katrahurë e vërtetë ku nxënësit e vijojnë mësimin aty, ju duhet të bëni diçka në këtë drejtim që të bëni lyerjen e shkollës brenda deri sa të ndërtohet ajo shkolla e re në mënyrë që të kenë kushtet themelore që duhet me i pas një nxënës dhe tjetra vijueshmëria e nxënësve prej një komunë në tjetrën ajo është e drejtë personale edhe nuk mundet askush me ndalu, pastaj sa i përket cilësisë së arsimtimit nuk është faji vetëm i drejtorit kjo është bartur që nga viti në vit, konkretisht çka duhet me bo drejtori mos i pranua aktivistët e vet që ne njohim, persona që janë aktivistë të partive të ndryshme politike që nuk i plotësojnë kriteret e në këtë bazë drejtori duhet me intervenua që vërtetë, që kur të pranojnë një arsimtarë duhet të pranohet tamam me kritere edhe që është i përgatitur me pranua në gjendje normale, e që kemi raste kur nuk i plotësojnë kriteret që mos të i përmendim me emra edhe mos të lëshohemi në këtë lloj niveli, në këtë bazë mundet me intervenua përndryshtë ishalla bëhet mirë sa i përket cilësisë.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Zhuniqi!

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, meqë tash e mora fjalën ju përshtendës të gjithëve, nënkyetarin e komunës, antarët e kuvendit, drejtorët, përfaqësues të mediave, OSBE-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Fillimi i falënderoj drejtorin për këtë informatë të shkruar në pikat e shkurta, desha me u lidh te ajo që 12 shkollat e komunës tonë kanë vazduar projektet e situara nga Banka Botërore në kuadër të cilave janë bërë disa furnizime me pajisje laboratorike dhe teknologji informative. E kësaj mendoj që ndoshta është dashur drejtori me na dhënë pak sqarime konkretisht p.sh. sa është numri i atyre pajisjeve laboratorike edhe teknologji informative, tash në pajisje laboratorike nuk mundet të na tregoj detajet por në teknologji informative me na tregua se kjo shkollë ka marrë kaq kompjuter, pra do të ishte një informatë më e plotë. Ju faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Fazliu!

**Sali Salltek** – Faleminderit kryesues, unë e falënderoj drejtorin për raportin që e ka bërë, ka mund të shtoj edhe numrin e nxënësve në përgjithësi se sa ka pas rëniet nëpër shkolla por e di që është një problem edhe në nivel të Kosovës e jo vetëm këtu te ne, por drejtori ka bërë mirë që po e mbani ekuilibrin e punëtorëve të arsimtimit në nivele të Komunës sepse po të dalim edhe ne sikur Kamenica vërtetë kemi me dal qesharakë shumë, nuk është e mirë as për nxënës edhe për punëtoret e arsimtimit. Këtu pritet me dal një rregullore në nivel të Ministrisë që të rregullohet kjo punë njëherë e përgjithmonë, më llogari kemi bo bartjen e nxënësve prej një shkolle në shkollën tjetër se sa të punojnë punëtorë p.sh. shkollën e Gexhës komunës ka me i kushtua 500 euro me bë bartjen e nxënësve për me ju dërgua në Malësi të Vogël kurse 5500 shkojnë në muaj për me i pagua për punëtoret në nivele shkolle pa i llogaritur shpenzimet tjera nxemjën e të gjitha probleme tjera që janë mirëpo për momentin është problem, lë të del një rregullore në nivel qeverie edhe të dalin me qëndrim të prerë edhe kryhet njëherë e përgjithmonë, Rukija foli edhe për korrikulën sidomos nëpër lëndë shkencore, çdo lëndë është shkencore ti Rukije, nuk ka lëndë që nuk është shkencë, korrikulet edhe programet i kanë të mira por ishalla shtohet pak më shumë vullneti pak më shumë me punua edhe me u rritë cilësia e nxënësve nivel komunë po ashtu edhe në nivel Kosove sepse jemi shumë dobët, tash sa do të mundemi me arrit do të shohim por është problem i madh numri i nxënësve. Faleminderit shumë.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Salltek, vërtetë informata e drejtorit ndoshta ka mundur siç e përmendën edhe kolegët tjerë me pas në brendësi të asaj edhe të dhëna tjera pak më tepër shtesë por meqenëse unë e falënderoj shumë pjesën e informatës që e ka sjellë, normal ne këtu që nuk i kemi pasur të shkruara ka deshtë me na kursyer që mos me i lexua edhe mundet me na dhanë edhe sqarime tjera, po znj. Krasniqi urdhëroni!

**Rukije Krasniqi** – Unë mendoj që mjetet mësimore të cilat vijnë në ndihmë rreth njësisë mësimore mendoj që e rrisin edhe cilësinë e mësimit jo vetëm në teori por edhe jemi dëshmitarë te gjithë se paku që 20 vite punojmë me një mësimdhënie vetëm teorike pa zbatim në praktike apo alamin e pjesëmarres në një mësimdhënie të n'duardurshme që e bën nxënësin më kreativ nuk mendoj që kemi një ngritje në cilësi këto të gjitha mjetet e demonstrimit përvëç lendeve shkencore që janë aty që e përmenda edhe Gjuhen shqipe, gjitha

**Ali Zhuniqi** – Faleminderit drejtorit për informatën, unë kisha vetëm një kërkesë konkrete, sa e pashë unë kontrata pér përfundimin ose pranimin teknik te ndërtimi i shkollës ka me përfunduar diku 2022, një kërkesë konkrete pér drejtorin pér shkollën fillore “Liria” në Fortesë, i kam kërkuar vazhdimisht që të bëhet lyerja e shkollës brenda sepse nxënësit janë në myk, kisha preferuar shumë më shpesh me vizitua atë shkollë, unë isha në zgjedhjet e fundit, e kam parë që është një katrahurë e vërtetë ku nxënësit e vijojnë mësimin aty, ju duhet të bëni diçka në këtë drejtim që të bëni lyerjen e shkollës brenda deri sa të ndërtohet ajo shkolla e re në mënyrë që të kenë kushtet themelore që duhet me i pas një nxënës dhe tjetra vijueshmëria e nxënësve prej një komunë në tjetren ajo është e drejtë personale edhe nuk mundet askush me ndalu, pastaj sa i përket cilësisë së arsimtës nuk është faji vetëm i drejtorit kjo është bartur që nga viti në vit, konkretisht çka duhet me bo drejtori mos i pranua aktivistët e vet që ne njohim, persona që janë aktivistë të partive të ndryshme politike që nuk i plotësojnë kriteret e në këtë bazë drejtori duhet me intervenua që vërtetë, që kur të pranojnë një arsimtarë duhet të pranohet tamam me kritere edhe që është i përgatitur me pranua në gjendje normale, e që kemi raste kur nuk i plotësojnë kriteret që mos të i përmendim me emra edhe mos të lëshohemi në këtë lloj niveli, në këtë bazë mundet me intervenua përndryshe ishalla bëhet mirë sa i përket cilësisë.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Zhuniqi!

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, meqë tash e mora fjalën ju pëershëndes të gjithëve, nënkyetarin e komunës, antarët e kuvendorit, drejtorët, përfaqësues të mediave, OSBE-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Fillimi i falënderoj drejtorin pér këtë informatë të shkruar në pika të shkurta, desha me u lidh te ajo që 12 shkollat e komunës tonë kanë vazhduar projektet e fituara nga Banka Botërore në kuadër të cilave janë bërë disa furnizime me pajisje laboratorike dhe teknologji informative. E kësaj mendoj që ndoshta është dashur drejtori me na dhënë pak sqarime konkretisht p.sh. sa është numri i atyre pajisjeve laboratorike edhe teknologji informative, tash në pajisje laboratorike nuk mundet të na tregoj detajet por në teknologji informative me na tregua se kjo shkollë ka marrë kaq kompjuter, pra do të ishte një informatë më e plotë. Ju faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Fazliu!

**Sali Salltek** – Faleminderit kryesues, unë e falënderoj drejtorin pér raportin që e ka bërë, ka mund të shtoj edhe numrin e nxënësve në përgjithësi se sa ka pas rënje nëpër shkolla por e di që është një problem edhe në nivel të Kosovës e jo vetëm këtu te ne, por drejtori ka bërë mirë që po e mbani ekuilibrin e punëtorëve të arsimtës në nivele të Komunës sepse po të dalim edhe ne sikur Kamenica vërtetë kemi me dal qesharakë shumë, nuk është e mirë as pér nxënës edhe pér punëtoret e arsimtës. Këtu pritet me dal një rregullore në nivel të Ministrisë që të rregullohet kjo punë njëherë e përgjithmonë, më llogari kemi bo bartjen e nxënësve prej një shkolle në shkollën tjetër se sa të punojnë punëtorë p.sh. shkollën e Gexhës komunës ka me i kushtua 500 euro me bë bartjen e nxënësve pér me ju dërgua në Malësi të Vogël kurse 5500 shkojnë në muaj pér me i pagua pér punëtoret në nivele shkolle pa i llogaritur shpenzimet tjera nxemjën e të gjitha probleme tjera që janë mirëpo pér momentin është problem, lë të del një rregullore në nivel qeverie edhe të dalin me qëndrim të prerë edhe kryhet njëherë e përgjithmonë, Rukija foli edhe pér korrikulën sidomos nëpër lëndë shkencore, çdo lëndë është shkencore ti Rukije, nuk ka lëndë që nuk është shkencë, korrikulet edhe programet i kanë të mira por ishalla shtohet pak më shumë vullneti pak më shumë me punua edhe me u rritet cilësia e nxënësve nivel komunë po ashtu edhe në nivel Kosove sepse jemi shumë dobët, tash sa do të mundemi me arrit do të shohim por është problem i madh numri i nxënësve. Faleminderit shumë.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Salltek, vërtetë informata e drejtorit ndoshta ka mundur siç e përmendën edhe kolegët tjerë me pas në brendësi të asaj edhe të dhëna tjera pak më tepër shtesë por meqenëse unë e falënderoj shumë pjesën e informatës që e ka sjellë, normal ne këtu që nuk i kemi pasur të shkruara ka deshtë me na kursyer që mos me i lexua edhe mundet me na dhanë edhe sqarime tjera, po znj. Krasniqi urdhëroni!

**Rukije Krasniqi** – Unë mendoj që mjetet mësimore të cilat vijnë në ndihmë rrëth njësisë mësimore mendoj që e irisin edhe cilësinë e mësimit jo vetëm në teori por edhe jemi dëshmitarë te gjithë se paku që 20 vite punojmë me një mësimdhënie vetëm teorike pa zbatim në praktike apo alamin e pjesëmarjes në një mësimdhënie të n'duardurshme që e bën nxënësin më kreativ nuk mendoj që kemi një ngritje në cilësi këto të gjitha mjetet e demonstrimit përvçe lendeve shkencore që janë aty që e përmenda edhe Gjuhen shqipe, gjitha

lëndët tjera i kontribuojnë në rritjen e cilësisë do të thotë që mjetet e demonstruese te gjitha lëndëve kontribuojnë në ngritjen e cilësisë. Ju faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit zj. Krasniqi, normal kur teoria hyjnë në pjesën e praktikës kompletohet dhe jemi duke u munduar me bë përpjekje, urdhëro drejtore ndoshta ke mundur me mbërr me i marrë shënimet.

**Avni Morina** – Faleminderit për kontributin tuaj të gjithësecilit, po shkoj me radhë do të mundohem të përgjigjem pyetjeve që më keni bërë, z. Masar Popaj, numri i nxënësve nuk dua të gabohem me shifra por e di që është diku 10.663 nxënës prej klasës së parë e deri në klasën e dyshëmjetë edhe ky numër kur pjesëtohet me numrin e mësimdhënësve është mesatarja diku mbi 14 % pra raporti mësimdhënës-nxënës pra një mësimdhënës 14 nxënës mesatarja është kjo është në nivel komune, për shifra më të sakta i kam në drejtori në qoftëse ju intereson mund t'i merrni sepse nuk i di me përqindje të saktë se sa ndryshon aty. Është keq që ndoshta nuk e kam paraqitur një informatë por edhe unë vet kam gabuar kur e kemi bërë planin e punës të kuvendit ndoshta është dashtë me bë raport e jo informatë atëherë në janar kur kemi bërë d.m.th. më mirë do të tingëllonte Raporti i DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollorë 2019/2020, se sa informatë sepse informata është shumë e shkurtë edhe informata nuk mund t'i përbledhë të gjitha ato aktivitete dhe punë që bëhen në një periudhë të caktuar siç është periudha gushtë-shtator që korrespondon me fillimin e vitit të ri shkollor. Është e vërtetë që në disa vende ku ka shkolla të vogla ka nxënës shumë pak sidomos në klasat e larta cikli i lartë klasa e tetë, e nënta por dorën në zemër deri me tash askë se kam hequr prej punës e as nuk jam për me heq prej punës askënd, edhe po ta hiqja dikë ose të bëja ndonjë makinacion, unë do të bie në kundërshtim edhe me ligjin e punës, inspektorati i punës më thotë çdo ditë punëtorë teknikë leje mos e hiq prej punës edhe nëse nuk ke fare orë me i dhënë punëtori që është duke punuar qe 10 vite 15 apo 20vite, lëre punëtorë teknik e mos e hiqe prej punës prandaj nuk kam guxuar të marr masa të tilla të reduktimit të numrit të mësimdhënësve pra jam munduar me ruajte numrin aktual të mësimdhënësve që është. Ne bazë të kornizës buxhetore edhe në bazë të planifikimit që kemi pasur gjatë viteve nuk po them vetë në këtë vit, ne në sektorin e Arsimit i kemi punëtorët duke filluar prej punëtorëve teknik e deri te drejtorët e shkollave me mësimdhënës e krejt i kemi 846 punëtorë d.m.th. prej 1166 sa janë në krejt komunën në sektorin publikë pra diku 80% janë në sektorin e Arsimit dhe ky numër është ai totali i përgjithshëm i numrit të punëtorëve që është brenda DKA-së. Vazhdimisht çdo muaj përballemi me futjen në listë të punëtorëve të ri kur ka konkurse sidomos po na shkaktojnë rastet kur janë pushimet e lehonive ose kur është dikur i sëmurë kur ka pushim mjekësore sepse vërtete ne sidomos në ciklin e ulët programi fillor nuk kemi qare pa marrë punëtorë të ri sepse te cikli i lartë kur janë lëndët ndoshta brenda sistemi ne ndoshta mund të sistemojmë dikë përkohësisht mund të i japim orë që ka mangu në mënyrë që të mos e rrisim numrin e punëtorëve por kur është rasti te punëtoret që janë në programin fillorë tek mësuesit klasorë mësueset klasore ne nuk kemi qare pa hapur konkurse dhe automatikisht po na rritet numri i mësimdhënësve, kur shkojmë i dërgojmë ndryshimet në Ministri atje, ata e shohin totalin 846 dhe nëse është 847 nuk ta pranojnë në listë të pagave por duhet me pritë një muaj, dy apo tre muaj e ndonjëherë edhe gjashtë muaj e nuk kemi mundur të i futim në listë të pagave pastaj i kemi kompensua muajt pasuese nderuara Fahrie Lushi-ish nxënësja ime, ikja e nxënësve nga shkollat tjera nuk mendoj që bëhet për shkak se mungon cilësia, unë mund të ju garantoj se cilësia në arsim ka karakter relativ, nuk mund të veçoja Prizrenin nga Rahoveci apo Gjakovën nga Rahoveci pothuajse jemi njejtë, mirëpo ndoshta ka drejtime që këtu nuk janë p.sh. siç janë drejtimet mjekësore kur ne e kemi vetëm një paralele e cila formohet një herë në 3 vjet për një shkollën profesionale edhe aty është numri i kufizuar p.sh. 25 nxënës më tepër nuk mund të pranojmë edhe ata nuk mund të gjunjë veten këtu dhe shkojnë diku tjetër, unë kam parë edhe në Prizren, Gjakovë edhe në Prishtinë shkolla dhe mësimdhënës që janë më të dobët se sa tonat.

Ne funksion të rritjes së cilësisë, unë këtu në informatë nuk e kam pasqyruar por prej fillimi të këtij viti e din edhe Rukija që është këtu, e din edhe Mirjeta që punon në arsim, ne i kemi punua si drejtori në harmonizim edhe i vlerësojmë edhe vlerësimet sepse vlerësimi i nxënësve ose vlerësimi i njojurive është njëri prej instrumenteve të vlerësimit i cili është mjaft i rëndësishëm, shume ka rëndësi se si e vlerëson njojuritë një mësimdhënës tek nxënësit dhe kemi bërë për herë të parë një harmonizim në nivel të komunës sipas fushave korrikulare instrumentet e vlerësimit janë unike dhe i kemi dorëzua të gjitha shkollat.

Projekti përfurnizimin e bibliotekave me libra është një projekte i përbashkët me drejtorin për Kulture rini dhe sporte, në vetëm një pjesë të asaj shumë që ka qenë e paraparë për këtë vite e kemi shfrytëzua si DKA dhe aq kemi patur mjete aq i kemi furnizua 5 shkollat te cilat i kemi shërbye edhe kërkesat që kanë sjell shkollat përndryshe edhe shkollën e Opterushës sivjet nuk e kemi lënë pa kurrgjë, i kemi dërguar 5 Smart tv kushtet janë shumë të mira dhe besoj qe ky kodë që është përfurnizimin e bibliotekave me libra ka me vazhdua edhe vitin e ardhshëm edhe do të i furnizojmë edhe shkollat tjera që kanë mungesë e aq më mirë kur shkolla e Opterushes ka kushte për me bë edhe kënd për lexim sepse ka hapësira të mjaftueshme për me krijuar kënd të leximit edhe ku me marr njerëz që lexojnë. Udhëtimi, unë pajtohem plotësisht me ish drejtorin e arsimit kur ne i marrim nxënësit prej një komunë tjetër dhe vinë të ne ai është përfitimi i joni për arsy se nëse nuk e dini buxheti i shkollës përmallra dhe shërbime është 23 euro për çdo nxënës p.sh. nëse shkolla Isa Boletini i ka 1000 nxënës atëherë 23000 euro e ka buxhetin vjetor përmallra dhe shërbime aty paguhen lëndë djegëse, paguhen te gjitha shërbimet komunale rryma uji edhe pastaj ato mjete nëse menaxhmenti i shkollës i shfrytëzon qysh duhet ato mund të përdoren edhe përiparime në shkollë, do prishje që mund të ekzistojnë në shkollë si prishja e ndonjë gypi të ujit apo edhe bravë të derës, ka nevojë përmjet konkretizimi shkolla, ka nevojë përlibra shkolla edhe me buxhete të shkollës mund të marrin libra, me pyeti një drejtor i shkollës së Çifllakut Gëzim Sahitaj, a me buxhet të shkollës apo me çfarë buxheti po e furnizoni? Unë i tregova që me të dyjat nga pak edhe me buxhetin paraparë me kod por edhe me buxhetin e shkollave, kryesore mos me mungua interesimi, unë ju kam bërë thirrje këshillave të shkollave edhe tek pyetja që më bëri mësuesi Arsim tek projektet e bankës botërore janë 12 shkolla është e vërtetë mirëpo ju kam parë përtë madhe edhe drejtorëve të shkollave dhe këshillave të shkollave pse p.sh. një pjesë të atyre mjeteve diku 1500-2000 euro shkollat, projektet me bankën botërore që i kanë përfituar shkollat i kanë shfrytëzuar p.sh. për shëtitje që është diçka e paarsyeshme pse p.sh. nuk ju ka shkuar ne mendje shkolla "Isa Boletini" në kuadër të asaj me shfrytëzua p.sh. edhe një 500 euro me nda përlibra, kur kam ardhë drejtor i arsimit jam tmerruar, shkolla më e madhe në komunë plot merimanga biblioteka e shkollës, shumë pluhur edhe as libra nuk kishte edhe tash qohet dikush aty thotë pse ke sjellur libra sepse unë po dua me pas libra edhe po dua me pas nxënës që lexojnë aty. Ju kam bërë thirrje drejtorëve por edhe këshillave të shkollave që maksimalisht t'i shfrytëzojnë këto fonde që i thihin nga jashtë, përsye se ne shëtitje mund të shkojmë kur të duam edhe me pare tonë se tek e fundit marrim rroga secili por ato mjete p.sh. konkretizimi njëherë vjen në tri vjet pse mos me i shfrytëzua mjetet e konkretizimit, janë shumë të nevojshme bile unë si fizikant e di qysh ndjehem kur nuk ka tjetër diçka veç shkumësit dhe tabela ndoshta edhe tabelën ku shkruaj nuk e kam qysh duhet. Janë bërë riparime edhe nëpër shkolla, ka pasur edhe ndërrime të dyerve edhe me buxhetin e shkollave nuk e mohoj këtë mirëpo krejt varet prej interesimit të këshillave drejtuese të shkollave prandaj në këtë aspekt duhet me punua më shumë, unë çdo ditë po jam nëpër shkolla edhe po bëj thirrje vazhdimisht që të angazhohen të gjithë mësimdhënësit te gjithë këshillat e shkollave edhe këshillat e prindërve sidomos ata duhet me angazhua maksimalisht që gjendjen nëpër shkolla ta shohim me syrin real ashtu siç është dhe të mundohen ta përmisojnë me ato të hyra që i kanë vjetore përvit, nuk është pak se çdo nxënës që e kanë numërohen ka 23 euro buxheti vjetor dhe ato janë të hyra të vazhdueshme çdo vite, pse mos me i shfrytëzua përtë mirën e nxënësve dhe të mësimdhënësve edhe cilësisë në arsim. Besoj që në këtë që thashë Rukije e gjete edhe përgjigjen time përpajisje mjete konkretizimi, ne nuk i përzihemi shkollës se çka dëshiron me marr me ato para që i ka, krejt varet nga Sakip Kryeziu, nga Nehat Duraku, nga këshilli i shkollës, nga këshilli i prindërve që është pjesë e këshillit të shkollës se si e menaxhon këtë, shembulli më i mirë e kemi Afrimin këtu, asambleistik e nderuar që punon në shkollën në Dejnë, e dinë ky fort mirë se nuk është shfrytëzuar buxheti i shkollës dhe si po shfrytëzohet tanë gjatë këtyre viteve të fundit dhe muajve të fundit, e keni parë edhe vet çfarë ndryshimi janë bërë me një angazhim shumë minimal ndoshta pra në gjithë këtë aspekte e gjitha varet prej angazhimit tonë që e kemi edhe si komunitet edhe si pjesë e shkollave. Ali Zhuniqi e ka bërë kërkesë përiyerjen e shkollës "Liria" në Fortesë, vërtetë është një projekt shumë i madh që shkolla ka nisë por unë e di çfarë kam hequr derisa e kam heq atë projekt të eficiencës së energjisë edhe e kam dërguar në Drenoc sepse shkolla e Fortesës "Liria" në Fortesë ka qenë projekt i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për investim në eficiencë të energjisë mirëpo kur e kemi parë

se ajo shkollë është përmbytë gjatë këtyre viteve, kur i kemi parë ato fotografi alarmante me ujë brenda nëpër klasë, kur i kemi parë ato mure plot myk atëherë kemi ardhë në përfundim se ajo shkollë duhet të ndërtohet e re sepse është në pikën më të ulët pa kurrfarë drenazhimi pa kurrfarë hidroizolimi me mure të vjetruara me myk në të gjitha anët edhe ka filluar shkolla e re, më mirë është të interesohemi që procesi i ndërtimit të shkollës të ndërtohet ose të kryhet para afatit edhe pse është me kontratë 3 vjeçare se sa të bëhet një investim sikur me thënë me gjuajte pare ne lloq. Diçka tjetër besoj që nuk kam harruar, këto ishin ato përgjigjet për të cilat edhe ju ishit të interesuar. Faleminderit shumë!

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për informatën, po urdhëroni Ali!

**Ali Zhuniqi** – Nuk ishte çështja te investimet te puna e energjisë së ripërteritshme, çështja ishte te lyerja e shkollës brenda por nuk ka lidhje ajo duhet, është shumë me rëndësi jetike nxënësit ku e zhvillojnë mësimin në çfarë ambienti.

**Avni Morina** – Drejtori i shkollës është Elhami Zhuniqi, a keni biseduar me të ndonjëherë me çështjen e lyerjes, me buxhet të shkollës ka mundur me lye shkollën, pa e fut hiq në telashe Avni Morinën, mirë është përgjegjësi edhe kur rrëzohet aty e kam përgjegjësi publike kështu më keni thënë edhe para 5 apo 6 muajve.

**Kryesuesi** - Faleminderit shumë drejtor, faleminderit kuvendarë të nderuar për kontributin, shihemi në mbledhjen e radhës. Faleminderit !

#### Mbledhja përfundoi në 13:30

01 Nr. 16 /2019  
Rahovec, 27.11.2019

Procesimbajtësi:

Agim Hoti

